



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 522 Akti

Nr. 522 Vendimi
Tiranë, më 1.4.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 30.3.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Aurel Arapi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e

Rrethit Gjyqësor Kurbin, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 30.3.2022, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Aurel Arapi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Aurel Arapi procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa (Bungo).
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe shqyrtoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Valbona Sanxhaktari. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- v. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Aurel Arapi, me vendimin nr. 2, datë 16.3.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Komisioni, në datën 16.3.2022, e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar atë për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë, deri në datën 28.3.2022, për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur qëndrimin e tij.
- vii. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ përmes postës elektronike, ndonëse nuk e ka tërhequr dosjen përkatëse, paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, në afatin e caktuar nga Komisioni.
- viii. Në vijim, në datën 29. 3.2022, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, të caktuar në datën 30.3.2022, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Aurel Arapi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Aurel Arapi parashtroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iii. Seanca dëgjimore e datës 30.3.2022 u mbyll, për të rifilluar më 1.4.2022 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të

justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament banimi me sip. 57 m², me vendndodhje lagjen “***”, Vlorë

1. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sip. 57 m², të ndodhur në lagjen “***”, Vlorë, si dhe një shtesë në këtë pasuri, sipas vetëdeklarimit për legalizim të datës 28.1.2015. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar trashëgiminë ligjore të çelur me dëshminë e trashëgimisë me nr. ***, datë 9.5.2016, me kërkesë të nënës D. A., për trashëgimlënësin F.A. Sipas dëshmisë së trashëgimisë¹ është pranuar ndarja e pasurisë mes subjektit, nënës dhe dy motrave të tij, ku secili zotëron ¼, pjesë të saj².
2. Përgjatë procesit të rivlerësimit, nga shqyrtimi i dokumentacioni të paraqitur nga subjekti³, ka rezultuar se kjo pasuri është përfutur fillimisht nga i ndjeri F. A. (babai i subjektit të rivlerësimit), nëpërmjet kontratës së privatizimit të banesës së datës 18.8.1993, e lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komonale të Banesave Vlorë dhe shtetasit F. A., në vlerën 1,613 lekë⁴. Në vijim, në vitin 2012, pasuria është rivlerësuar nga babai i subjektit të rivlerësimit në vlerën 2,405,913 lekë.
3. Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë, është bërë me dije se shtetasi F. A. me anë të formularit nr. *** prot., datë 28.1.2015, ka aplikuar për legalizimin e objektit informal. Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, ka rezultuar se Këshilli i Qarkut Vlorë, Drejtoria e Urbanistikës⁵, ka përcjellë një kopje të lejes së ndërtimit, sipas vendimit nr. ***, datë 11.10.1995, të KRRT-së së Rrethit Vlorë, me objekt “shtesë ballkoni në banesën nr. 535”, e cila i është dhënë shoqërisë ndërtuese të përfaqësuar nga z. A.D. Po ky institucion⁶, i ka dorëzuar aplikuesit planvendosjen e shtesës në godinën nr. ***, në të cilën ndodhet apartamenti.
4. Nëpërmjet deklaratës⁷ së datës 28.1.2015, “Për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje”, babai i subjektit të rivlerësimit F. A., ka aplikuar për legalizimin e shtesës së kryer në pasurinë në analizë⁸.
5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit dhe ndërtimit të shtesës ka qenë në moshën 8-vjeçare, ndërsa në lidhje me shtesën, ka deklaruar se ajo është në proces legalizimi dhe ende nuk ka një vendimmarrje. Për sa i përket investimit të kryer në pasurinë në analizë, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat dhe kursimet e prindërve, ndër vite, pasi kanë qenë vazhdimisht në marrëdhënie pune.

¹Referuar certifikatës së pasurisë së datës 17.5.2016, për pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në z. k. ***, të regjistruar në bashkëpronësi të subjektit Aurel Arapi, dy motrave A. L. dhe D. A., si dhe nënës D. A., në masën 25% secili.

²Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se pas vdekjes së nënës së tij më 23.10.2018, pavarësisht se nuk janë kryer veprimet përkatëse në ZVRPP-në Vlorë, pjesa takuese e tij në pasurinë e sipërcituar është 1/3 e kësaj pasurie.

³Me dorëzimin e deklaratës *Vetting* në ILDKPKI.

⁴Neni 9 i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, përcakton se: “...banesat që do privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij...”.

⁵Në shkresën me nr. *** prot., datë 20.3.2012.

⁶Nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 10.5.2012.

⁷Në këtë deklaratë, babai i subjektit ka deklaruar se ndërtimi në fjalë është kryer në vitin 2005.

⁸Sipas kërkesës së ZVRPP-së Vlorë me nr. *** prot., datë 23.7.2012, me përmbajtje: “Në përgjigje të aplikimit tuaj me nr. ***, të datës 10.5.2012, ju sqarohet se duhet të sillni vërtetim pronësie, aktivlerësimi të parcelës dhe mandatpagesë, ku të tregohet blerja e truallit, deklarata kufitarësh para noterit, deklaratë personale”.

6. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se të dy prindërit e tij kanë ndërruar jetë vite më parë dhe, për këtë arsye, nuk disponon dokumentacion tjetër, përveç një kopje të preventivit të punimeve (pa datë) dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë ndërtuese, z. A. D. Në këtë preventiv është pasqyruar kosto e punimeve në vlerën 75,994 lekë, nga të cilat TVSH-ja në vlerën 12.5% (8,444 lekë).
7. Në një këndvështrim historik të evoluimit të ligjit, ka rezultuar se kjo shkallë tatimore është aplikuar sipas ligjit nr. 7928 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, datë 27.4.1995, i ndryshuar në vijim me ligjin nr. 8240, datë 16.9.1997, sipas të cilit është miratuar ndryshimi i TVSH-së, në shkallën tatimore prej 20%. Për rrjedhojë, ky preventiv duhet të jetë lëshuar brenda periudhës maj 1995 – shtator 1997.
8. Përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ASHK-ja⁹ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të tjera të regjistruara në emër të subjektit apo të personave të lidhur, veç asaj të deklaruar prej subjektit. Komisioni ka kryer edhe verifikimin *online*, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, nga ku ka rezultuar e regjistruar pasuria me të dhënat e përshkruara më sipër, në bashkëpronësi, sipas deklarimit të subjektit¹⁰.
9. Nga FSHU-ja, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 14.8.2020, është bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk ka rezultuar kontratë furnizimi me energji elektrike. Ndërsa është konfirmuar ekzistenca e dy kontratave në Vlorë dhe në Burrel, në emër të shtetas D. A.¹¹. Nga UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 20.8.2020, është bërë me dije se nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, si dhe nga Arkivi i UKT-së nuk kanë rezultuar kontrata për shërbime të lidhura me këtë institucion në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.
10. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr. ***, që i përket apartamentit në analizë, të lidhur me OSHEE-në, në emër të shtetasit F. A., si dhe të ujit të pijshëm, e cila ka rezultuar në emër të shtetasit H. A.¹².
11. Në këto kushte, nisur nga konsiderimi i fakteve të konstatuara – konkretisht se: (i) nuk ka pasur ndonjë kontribut nga subjekti i rivlerësimit lidhur me përfitimin e pasurisë së

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme ASHK-së, bashkëlidhur së cilës gjenden shkresat kthim përgjigje të ASHK-ve në rrethe. ASHK-ja Vlorë, nuk ka kthyer përgjigje dhe, për rrjedhojë, Komisioni ka përsëritur kërkesën për informacion, lidhur me ekzistencën e mundshme të pasurive në emër të subjektit apo personave të lidhur. Në përgjigje të kërkesës, ASHK-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021, ka refuzuar dhënien e informacionit, me argumentin se për aksesin në informacion pranë këtij institucioni duhet ndjekur procedura e përcaktuar në aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtij institucioni.

¹⁰Gjithashtu, po nga ky sistem ka rezultuar se në datën 22.8.2013 ka rezultuar e regjistruar në z. k. ***, pasuria e llojit apartament nr. ***, me sip. 66,5 m², me adresë rruga “D. Gj.”, Tiranë, në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit dhe katër bashkëpronare. Nga kartela e pasurisë rezultojnë bashkëpronarë shtetasit A. N., V. B., F. A., P. A. dhe F. A. Referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar me ligjet nr. 9367, datë 7.4.2005, nr. 9475, datë 9.2.2006, nr. 9529, datë 11.5.2006, nr. 9530, datë 11.5.2006, nr. 9 584, datë 17.7.2006, nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe nr. 45/2014, datë 24.4.2014), konkretisht në pikën 5, të nenit 7, përcaktohet se: “Për qëllim të deklarimit periodik vjetor...[...], ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë”. Me shtesat dhe ndryshimet që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017 dhe nr. 105/2018, datë 13.12.2018, në gamën e personave të lidhur u shtua edhe “bashkëjetuesi/ja”. Në këtë këndvështrim është vlerësuar se subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin e pasurive të prindërve, që ata disponojnë veçmas, për sa kohë referuar të dhënave të sistemit multifunksional të ASHK-së, pasuria figuron në bashkëpronësi të babait të tij me disa persona të tjerë dhe nuk provohet ekzistenca e të drejtave reale të subjektit të lidhura me këtë pasuri, për sa kohë në trashëgiminë e çelur nuk është përfshirë kjo pasuri.

¹¹Në këtë shkresë FSHU-ja ka sqaruar se nuk disponon të dhëna personale të abonentëve, veç emrave dhe mbiemrave dhe për këtë arsye është në pamundësi për të identifikuar nëse dy kontratat e konstatuara i përkasin shtetas D. A. për të cilën Komisioni ka kërkuar informacion.

¹²Gjyshi nga babai, i subjektit të rivlerësimit.

privatizuar në vitin 1993 dhe as në ndërtimin e sipërfaqes shtesë deri në vitin 2005 (rreth 8 vjet përpara fillimit të detyrës); (ii) bashkëpronësia e subjektit në apartamentin në fjalë, në masën 25%, rrjedh nga trashëgimia ligjore; (iii) duke pasur në vëmendje qëndrimin jurisprudencial të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit¹³ – Komisioni vlerësoi se nuk kishte arsye për kryerjen e hetimeve/verifikimeve të mëtejshme, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë, në çdo rast nuk do të mund të evidentohet ndonjë përgjegjësi eventuale e këtij të fundit.

2. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite

12. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se nga momenti i marrjes së detyrës në datën 21.10.2013 deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, ka banuar në adresat: (a) apartament i ndodhur në lagjia “****”, pallati ***, Vlorë; (b) apartament i ndodhur në rrugën “A. V.”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, Tiranë, gjatë periudhës janar 2012 – qershor 2015; (c) apartament në përdorim përgjatë periudhës korrik 2015 – janar 2017, në adresën rruga “H. H. D.”, pallati “A. C.”, apartamenti nr. ***, kati ***, Tiranë.
13. Në lidhje me adresën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si vendbanim në lagjen “****”, pallati ***, Vlorë, referuar deklaratën të subjektit, por edhe nga konstatimi përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se apartamenti i ndodhur në këtë adresë përkon me pasurinë e deklaruar nga subjekti në bashkëpronësi, e cila është trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi.
14. Ndërsa, në lidhje me adresën e deklaruar si vendbanim në rrugën “A. V.”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, Tiranë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë nr. *** rep., datë 21.01.2012, me afat të përcaktuar 1 vit, me të drejtë ripërtëritje. Kontrata është lidhur ndërmjet nënës së tij dhe pronares së apartamentit, znj. M. D., një vit më përpara se sa subjekti të fillonte detyrën si gjyqtar. Qiraja e përcaktuar ka qenë në vlerën 35,000 lekë/muaj¹⁴. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur një vërtetim¹⁵ nga “I. S. Bank”, që provon kryerjen e pagesave mujore të qirasë dhe pagesave mujore të energjisë elektrike dhe të ujit për apartamentin në fjalë.
15. Përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer verifikimin në sistemin multifunksional të ZVRPP-së, nga i cili ka rezultuar se pasuria në fjalë me nr. ***, vol. ***, f. ***, përshkruar në kontratën e qirasë është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve M.D., M. D., B. D. dhe L. D., të cilët e kanë përfituar nëpërmjet privatizimit të banesave shtetërore.
16. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të subjektit, të viteve 2013 dhe 2014, ka rezultuar se adresa e vendbanimit është përshkruar rruga “A. V.”, pall. ***, ap. ***, Tiranë. Ndërkohë që përgjatë hetimit nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se pallati mban nr. *** dhe apartamenti mban nr. ***.
17. Në lidhje me vendbanimin në apartamentin, me adresë: rruga “H. H. D.”, pall. “A. C.”, nr.***, k. ***, Tiranë, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 1, se apartamentin në fjalë e ka marrë në përdorim pa kundërshtim përgjatë periudhës korrik 2015 – janar 2017, nga kunati i tij (bashkëshorti i motrës) z. M. L., me kusht, shlyerjen e detyrimeve përkatëse për konsumin e energjisë elektrike dhe ujit përgjatë periudhës së përdorimit të tij.

¹³Shihni vendimin nr. 7/2020, të KPA-së.

¹⁴Në vijim është konstatuar se është zgjidhur sipas marrëveshjes noteriale nr. ***, datë 26.6.2015.

¹⁵Vërtetimin nr. ***, datë 23.7.2021, të lëshuar nga “I. S. Bank”, dega Vlorë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur certifikatën e pronësisë së apartamentit nr. pasurie ***, z. k. ***, regjistruar në emër të shtetasit M. L.

18. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, nga shtetasi M. L., në të cilën ky i fundit ka deklaruar se apartamentin në fjalë e ka përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë nr. ***, datë 12.12.2009, të cilën subjekti e ka vënë në dispozicion të Komisionit në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Nga shqyrtimi i kontratës së sipërmarrjes me referencat e sipërpërmendura, ka rezultuar se çmimi i apartamentit ka qenë i përcaktuar në vlerën 97,664 euro, nga të cilat 72,000 euro janë likuiduar në llogarinë e sipërmarrësit dhe pala blerëse detyrohej të shlyente shumën e mbetur prej 25,664 euro.
19. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, mbi kohën e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit në fjalë, subjekti ka paraqitur mandatpagesat e shlyerjes së vlerës prej 72,000 euro, të cilat janë paguar përkatësisht: vlera 50,000 euro në datën 21.11.2008; vlera 10,000 euro në datën 4.12.2009; si dhe vlera 12,000 euro në datën 12.12.2009. Lidhur me pagesën e diferencës prej 25,664 euro, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 26.1.2017, të lëshuar nga shoqëritë “A. C.” sh.p.k. dhe “B.” sh.p.k., të cilat kanë bërë me dije se diferencën prej 25,664 euro, z. M. L. e ka përfituar si ulje nga kompania ndërtuese, pas rakordimit mes palëve për disa punime të kryera nga blerësi, si dhe për vonesën e dorëzimit të apartamentit.
20. Nga dokumentacioni i paraqitur, është konstatuar se palët kanë nënshkruar procesverbalin për dorëzimin e apartamentit në fjalë në datën 20.12.2016, pas rakordimit të detyrimeve, ndërkohë që subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar banimin në këtë apartament prej muajit qershor të vitit 2015. Në lidhje me këtë mospërputhje mes fakteve dhe deklarimeve të subjektit, sa i përket periudhës së pretenduar të banimit dhe disponibilitetit/gjendjes faktike të apartamentit për banim, subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 4 ka shpjeguar se shoqëria ndërtuese ka lidhur kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë për apartamentin e mësipërm që në vitin 2014, pasi që në atë periudhë apartamenti në fjalë ka qenë i banueshëm. Edhe pse i papërfunduar tërësisht për shkak të mungesës së ashensorit apo të ndonjë rifiniture të brendshme, blerësit i është dorëzuar një kopje e çelësave, me qëllim kryerjen e përmirësimeve/plotësimeve, mobilimin dhe përdorim, ndonëse dorëzimi formal dhe përfundimtar i objektit është bërë në muajin dhjetor të vitit 2016, sipas procesverbalit përkatës të paraqitur.
21. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ, është konstatuar se në të njëjtin pallat, z. M. L. ka pasur edhe një apartament tjetër në pronësi të tij, lidhur me të cilin subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka deklaruar se ky nuk është përdorur asnjëherë prej tij. Subjekti ka paraqitur kopje të kontratave të furnizimit me ujë dhe energji elektrike¹⁶ me qëllim dokumentimin e pagesave të kryera sipas klauzolës së përcaktuar në deklaratën noteriale të shtetasit M. L. Gjithashtu, përmes tyre është konstatuar se duke filluar nga shkurt 2015 – janar 2017, ka pasur tarifime për furnizimin me energji elektrike të të dy apartamenteve të ndodhur në adresën rruga “H. H. D.”, në objektin e ndërtuar nga shoqëria “A. C.” sh.p.k., në pronësi të shtetasve M. dhe A. L.
22. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka administruar¹⁷ nga FSHU-ja, informacionin në lidhje me faturimet për të dy apartamentet në pronësi të shtetasit M. L., nga shqyrtimi i tyre është

¹⁶Librezë e furnizimit me energji elektrike, kontrata nr. ***, e lidhur me OSHEE-në Tiranë për furnizimin me energji elektrike të apartamentit; librezë e furnizimit me ujë kontrata nr. ***, e lidhur me UK Tiranë për apartamentin.

¹⁷Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 28.1.2022.

konstatuar se të dyja kontratat janë lidhur në muajin korrik të vitit 2014 dhe kanë rezultuar faturime dhe pagesa të kryera për periudhën nga viti 2015 e në vijim¹⁸.

23. Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga FSHU-ja, krahasuar me librezat e paraqitur nga subjekti, ka rezultuar se nga të dy burimet e informacionit konfirmohet se faturimet dhe pagesa utilitare të kontratës me nr. ***, që i përket banesës së deklaruar në përdorim nga subjekti¹⁹ i rivlerësimit, ka shpenzuar energji elektrike në një kronologji që ndjek periudhën e përdorimit nga subjekti duke filluar nga viti 2015 e në vijim, duke e konfirmuar kështu shpjegimin e tij lidhur me këtë vendbanim.
24. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se në vitin 2017 është larguar nga apartamenti në pronësi të kumatit të tij dhe ka marrë në përdorim një apartament, me sipërfaqe 100,74 m², ndodhur në rrugën “H. H. D.”, ap. ***, Tiranë, nëpërmjet kontratës së qirasë nr. ***, datë 2.11.2017. Nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se apartamenti ka qenë në pronësi të shtetasit A. B., i cili kishte autorizuar nëpërmjet prokurës së posaçme shtetasin M. K. për kryerjen e veprimeve juridike në lidhje me pronën, ndër të tjera, edhe dhënien me qira dhe nënshkrimin e kontratës së qirasë për këtë apartament.
25. Në vijim, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur kontratën e porosisë së shtetasit A. B. me nr. ***, datë 27.11.2008, të nënshkruar prej porositësit A. B. dhe sipërmarrësit shoqëria “A. C.” sh.p.k., e investitorit shoqëria “B.” sh.p.k. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur mandatpagesat për likuidimin e faturave të energjisë elektrike dhe ujësjellësit, të cilat janë lidhur në emër të z. A. B..
26. Në lidhje me shtetasin A. B., subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore apo familjare. Gjithashtu, përgjatë hetimit, nga verifikimet dhe korrespondencat e kryera nga Komisioni, nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti me palë këtë shtetas.
27. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime si vijon:
 - Duket se ka mospërputhje midis: (i) adresës së përshkruar në kontratën e qirasë; (ii) adresës së deklaruar nga subjekti në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2014; si dhe (iii) adresës të përshkruar në përgjigje të pyetësorëve.
 - Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar përdorimin e apartamentit të lartpërmendur në deklaratën Vetting, ndryshe nga përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, por shpjegimet dhe rrethanat e deklaruara përgjatë hetimit administrativ, duket se janë konfirmuar nga hetimet dhe verifikimet e kryera nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28. Subjekti ka pretenduar se në lidhje me mospërputhjet e konstatuara nga Komisioni është bërë një lapsus në të dhënat e deklaruara të numrit të pallatit dhe apartamentit, por në të dhënat e tjera të pasqyruara në kontratën e qirasë, rezulton se bëhet fjalë për të njëjtin apartament në pronësi të shtetasit (qiradhënëses) M. D., pasi ekstremitetet e kontratës së qirasë (nr. repertori, nr. koleksioni, datë) janë të njëjta në të gjitha deklaratimet periodike vjetore, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar, po kështu edhe vlera e qirasë.
29. Për sa i përket mosdeklarimit të përdorimit të apartamentit, subjekti ka sqaruar se është thjesht një harresë për specifikim, sipas mënyrës së plotësimit të deklaratës, ndonëse e ka deklaruar, pikërisht, atë pasuri në përdorim, duke shënuar adresën e banimit, si dhe madje edhe duke paraqitur provën shkresore mbi pronësinë, të bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.

¹⁸Sipas përgjigjes së dërguar nga FSHU-ja me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2022.

¹⁹Referuar deklaratimit të tij në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

Vlerësimi i trupit gjykues

30. Trupi gjykues, në analizë të materialit të administruar, i ka vlerësuar shteruese dhe bindëse shpjegimet e subjektit dhe në referencë të jurisprudencës të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁰, ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e subjektit. Ky konkluzion bazohet në faktin se trupi gjykues çmon se mosdeklarimi eksplicit në DIPP-në, mbi përdorimin e një pasurie të paluajtshme në pronësi të personave të tretë, ndonëse përbën një pasaktësi në deklaratat periodike vjetore, nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 – për më tepër, kur adresa përkatëse është deklaruar saktësisht, ndër vite dhe deklaratës *Vetting* i është bashkëlidhur edhe një dokument mbi pronësinë e apartamentit. Për rrjedhojë, rrethanat e mësipërme nuk përbëjnë elementë të mjaftueshëm për t’u konsideruar si një deklaram i pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
31. Gjithashtu, në lidhje me apartamentin në pronësi të shtetasit M. L., të përdoruar përkohësisht nga subjekti i rivlerësimit, pa kundërshpërblim, në funksion të një marrëdhënie të posaçme, trupi gjykues, nisur nga faktet se: (i) më herët, Komisioni e ka shqyrtuar këtë pasuri, duke konkluduar nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 15.11.2018, se ishte në pronësi të z. M. L. dhe bashkëshortes A. L. (subjekt rivlerësimi) – duke mbërritur në disa konkluzione me efekte dhe pasoja përkatëse direkte në rivlerësimin e kësaj të fundit – rrethanë kjo e konfirmuar me vendimin (JR) nr. 28, datë 23.9.2019, edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Për rrjedhojë, rishqyrtimi i kësaj pasurie nën këndvështrimin e burimit të ligjshëm, do të binte ndesh me parimin “*ne bis in idem*”; (ii) pasuria në fjalë është blerë nga bashkëshorti i motrës së subjektit, i cili ka likuiduar detyrimin ndaj palës shitëse, brenda vitit 2009 – rreth 4 vjet përpara emërimit të subjektit të rivlerësimit në detyrë në vitin 2015, kur ishte ende student – trupi gjykues ka vlerësuar se nuk kishte shkak për (ri)kryerjen e hetimeve mbi burimet e krijimit të kësaj pasurie, vetëm për faktin se ajo është përdorur përkohësisht nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë nuk ka rezultuar që ky i fundit të ketë pasur ndonjë kontribut financiar për krijimin e saj. Kësisoj Komisioni, në respektim edhe të parimit “*ne bis in idem*”, lidhur me këtë pasuri nuk ka gjetur asnjë rrethanë penalizuese për subjektin.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz C270”, në vlerën 250,000 lekë

32. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, automjetin tip “Mercedes-Benz C270 CDI”, prodhim i vitit 2004, me targa ***, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.3.2016 dhe të regjistruar në pronësi të subjektit më 20.4.2016²¹. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (a) të ardhurat nga kursime personale; (b) të ardhurat nga paga si gjyqtar.
33. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes së automjetit me referencat e sipërcituara të nënshkruar mes palës shitëse Rr. M. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimi Aurel Arapi. Çmimi i blerjes i përcaktuar në kontratë ka qenë në vlerën

²⁰Në vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020 dhe nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020.

²¹Vërtetim, datë 6.1.2017, nga DPSHTRR-ja Vlorë, ku vërtetohet se shtetasi Aurel Arapi është pronar i automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

250,000 lekë²². Nga DPSHTRR-ja²³ është vënë në dispozicion dosja e automjetit në analizë, nga e cila ka rezultuar se fillimisht automjeti ishte blerë nga shtetasi Rr. M. nëpërmjet kontratës me nr. ***, datë 17.7.2010, kundrejt çmimit 500,000 lekë. Referuar të dhënave të pasqyruara në këtë dosje ka rezultuar se automjeti ka hyrë në shtetin shqiptar për herë të parë në vitin 2009 nga shtetasi B. M., blerë në shtetin gjerman me çmimin 7,800 euro dhe është paguar tarifa doganore në vlerën 532,469 lekë. Ndërsa, subjekti e ka blerë këtë automjet rreth 6 vjet më pas, në vlerën 250,000 lekë.

3.1 Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë së llojit automjet

34. Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të kësaj pasurie, të cilat, sipas deklaratës *Vetting*, kanë qenë: (a) kursime personale; (b) të ardhura nga paga. Nga analiza e deklaratës periodike të vitit 2015²⁴, duket se në fund të vitit 2015, subjekti ka pasur një gjendje *cash* në banesë në vlerën prej 600,000 lekësh²⁵, gjendje kjo e deklaruar dhe në DIPP-në e vitit 2016, në të cilën është detajuar burimi i krijimit të ardhurat dhe kursimet nga paga si gjyqtar në vlerën 350,000 lekë plus 250,000 lekë diferenca ndërmjet gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2015 dhe shpenzimit për blerjen e automjetit në vlerën 250,000 lekë.
35. Po ashtu, nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit dhe pjesëtarëve familjes së tij, ka rezultuar se përgjatë periudhës janar 2016 – 7.3.2016 janë kryer tërheqjet përkatësisht nga llogaria e pagës së subjektit dhe nga llogaria e pensionit të nënës së tij, në shumën totale 293,500 lekë.
36. Nga sa më sipër, Komisioni ka përfshirë në analizë edhe shumën prej 250,000 lekësh të deklaruar si të shpenzuar nga kursimet *cash* në banesë, si dhe të ardhurat e vitit 2016, deri në datën e blerjes së automjetit. Pas përlllogaritjes edhe të shpenzimeve të familjes së subjektit, deri në datën e kryerjes së pagesës së automjetit më 7.3.2016, ka rezultuar si vijon.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 1.1.2016 – 7.3.2016

Të ardhura nga paga e subjektit janar - 7.3.2016	269 500
Të ardhura nga pensioni i nënës janar - 7.3.2016	24 000
Kursime <i>cash</i> në banesë	250 000
Shpenzime të familjes janar - shkurt 2016	- 134 346
Shpenzim për blerjen e automjetit	- 250 000
Rezultati	159 154

37. Nisur nga të dhënat e lartpërshkruara, trupi gjykues ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës së automjetit në analizë, në vlerën prej 250,000 lekësh dhe e ka deklaruar saktësisht këtë pasuri, duke mos u konstatuar problematika në lidhje me të.

²²Nga verifikimi i kryer *online*, në sistemin elektronik të AMF-së, nuk kanë rezultuar të regjistruar automjete të tjerë në pronësi/përdorim, të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të. Ndërsa, nga të dhënat në sistemin *TIMS*²² janë konstatuar udhëtime të subjektit me disa automjete, të ndryshëm nga ai në pronësi, përkatësisht me targa ***, ***, ***, ***. Komisioni ka kryer verifikimin *online* në sistemin e AMF-së, me qëllim evidentimin e pronarëve të automjeteve të sipërcituar. Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe asaj Kurbin në lidhje me verifikimin e ekzistencës së konfliktit të mundshëm të interesit, të subjektit me shtetasit të cilët ka rezultuar pronarë të mëparshëm të automjetit në fjalë. Në përgjigje të sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datës 8.7.2021. Gjithashtu, nga gjykatat është konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë këta shtetas.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 19.8.2020.

²⁴Viti i krijimit të pasurisë “automjet”.

²⁵Në vitin e mëparshëm subjekti ka pasur gjendje *cash* shumën 250,000 lekë, ndërsa në vitin 2015 ka deklaruar shtesë gjendje *cash* në banesë shumën 350,000 lekë.

4. Gjendje *cash* në vlerën 600,000 lekë

38. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2014, gjendje *cash* në vlerën 250,000 lekë, duke deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie, kursimet e tij nga paga.
39. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar një shtesë të gjendjes së të hollave të disponuara *cash* në banesë, të krijuar nga kursimet nga paga, në vlerën 350,000 lekë dhe në vijim, në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 600,000 lekë. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kursimet nga paga ndër vite.
40. Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka rezultuar sa vijon:
- Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2014, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 208,740 lekë, për të mbuluar shpenzimet e familjes dhe për të krijuar kursimet e pretenduara në vlerën prej 250,000 lekësh.
 - Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2015, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 285,229 lekë, për të mbuluar shpenzimet e familjes dhe për të shtuar kursimet e pretenduara në vlerën prej 350,000 lekësh.
 - Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2016, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 162,298 lekë, për të mbuluar shpenzimet e familjes dhe për të rikrijuar kursimet *cash* në vlerën 250,000 lekë (të shpenzuara këto për blerjen e automjetit trajtuar në pikën 2 të relacionit) të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për krijimin e gjendjeve *cash* në banesë

	2014	2015	2016
Të ardhura nga paga e subjektit	992 286	1 017 237	1 061 569
Të ardhura nga pensioni i nënës	128 850	130 713	132 322
Të ardhura nga pensioni i babait	184 589	185 046	0
Të ardhura nga paga e motrës	41 800	0	0
Shpenzime të familjes	-1 342 025	-1 224 530	-1 101 302
Investime të familjes	0	0	-250 000
Gjendje <i>cash</i> në fund të vitit	-250 000	-600 000	-600 000
Gjendje <i>cash</i> në fillim të vitit	0	250 000	600 000
Gjendje në llogaritë bankare në fund të vitit	-4 765	-48 461	-53 348
Gjendje në llogaritë bankare në fillim të vitit	40 525	4 765	48 461
Rezultati	-208 740	-285 229	-162 298

41. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar përgjatë procesit të rivlerësimit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *Vetting*, gjendjet në llogaritë e tij bankare apo të personave të lidhur me të, ndonëse kanë pasur vlera minimaliste, pa ndonjë peshë specifike në balancat financiare. Lidhur me këtë konstatim, trupi gjykues, në referencë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, çmon se pasaktësitë e konstatuara si më lart, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për çdo alternativë të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shërbejnë si një shkak për të konkluduar se vlerësimi tërësor i pasurisë së tij ka problematika lidhur me parashikimet e nenit D të Aneksit Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
42. Nisur nga analiza financiare si më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me:

- Duket se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2014 dhe 2015, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në total në vlerën 493,969 lekë, për të mbuluar shpenzimet e familjes dhe për të krijuar kursimet e pretenduara, në vlerën 600,000 lekë. Gjithashtu, duket se në vitin 2016, subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 162,298 lekë, për të mbuluar shpenzimet e familjes dhe për të rikrijuar gjendjen e kursimeve prej 250,000 lekë, të shpenzuara më herët gjatë vitit për blerjen e automjetit

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43. Subjekti ka bërë me dije se në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe gjetjet për balanca negative për vitet 2014, 2015 dhe 2016, duke mos qenë dakord me këto konkluzione, i është drejtuar një eksperti kontabël, i cili ka vlerësuar se balancat e analizës financiare të viteve 2014 – 2016 janë pozitive, sipas pretendimeve në vijim.
44. Konkretisht, në analizën financiare të vitit 2014 rezulton se të ardhurat e llogaritura të motrës së subjektit janë marrë parasysh vetëm të ardhurat *neto* nga paga për muajin janar 2014. Shuma *neto* e përfituar nga paga është 81,200 lekë (paga e muajit dhjetor 2013 + janar 2014). Në analizën financiare të vitit 2015, subjekti ka pretenduar të përfshihen të ardhurat *neto* të përfituara prej tij për orët jashtë orarit të punës muaji tetor – dhjetor 2015 në vlerën 197,989 lekë, sipas vërtetimit nr. ***, datë 11.3.2016, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.
45. Në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve jetike, subjekti ka pretenduar të merret në konsideratë fakti që shpenzimet jetike të prindërve janë përballuar me pensionin e pleqërisë. Eksperti bazuar në metodën e llogaritjes nga INSTAT-i të shpenzimeve jetike ka llogaritur shpenzimet për të dy prindërit me nivelin bazë në shumën 6,246 lekë/frymë (kuantili i kategorisë 1) dhe për dy pjesëtarët e tjerë të familjes me nivelin mesatar vjetor për konsum për frymë në shkallë vendi në vlerën 219,998 lekë/frymë.
46. Në lidhje me përlllogaritjen e kryer nga Komisioni për shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit, të cilat janë llogaritur 50 euro/ditë qëndrimi, subjekti ka pretenduar se numri i ditëve të qëndrimit është llogaritur në mënyrë të gabuar ditë të plota, duke mos u bazuar në udhëzimin nr. ***, datë 10.7.2013, të Ministrisë së Financave dhe në VKM-në nr. 870, datë 14.12.2011.
47. Ndërsa lidhur me shpenzimet e transportit, për të cilat Komisioni i ka përlllogaritur në vlerën 400 lekë/dita deri në momentin e blerjes së automjetit dhe 1,000 lekë/dita për udhëtimin me automjet, subjekti ka pretenduar se referuar INSTAT-it shpenzimet e transportit janë parashikuar në vlerën 4,609 lekë/person në muaj. Bazuar metodës të llogaritjes të shpenzimeve të transportit duket qartë shuma e mësipërme duhet të zbritet si vlerë e llogaritur njëherë. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se duke qenë i angazhuar edhe në procesin e delegimeve, nëpër rrethe të tjera gjyqësore Mat, Lezhë, Krujë, Dibër, etj. dhe transporti në këto rrethe për pjesëmarrje në proceset gjyqësore së bashku me kolegët e tjerë të gjykatës, është kryer me automjetin e institucionit dhe jo me automjetin personal (duke llogaritur që vetëm për periudhën 2015-2016 ka pasur 24 delegime). Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) raport ekspertimi, datë 25.3.2022, i ekspertit A. M. dhe analizë financiare; (ii) vërtetim për delegimet nr. ***, datë 23.3.2022.

Vlerësimi i trupit gjykues

48. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet e subjektit, si dhe dokumentacionin mbështetës, analizoi sërish tematikat dhe zërat e analizës financiare mbi të cilat subjekti kishte ngritur pretendime, duke mbërritur në përfundimet që vijojnë.
49. Për sa i përket të ardhurave shtesë të subjektit dhe të motrës së tij, trupi gjykues e konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit, për arsye se, duke konsideruar dhe analizuar të ardhurat sipas vërtetimeve të lëshuara nga institucionet përkatëse, është (ri)konstatuar se: (i) paga e muajit dhjetor të vitit 2013, e motrës së tij ka kaluar në fakt në datën 31.12.2013 dhe jo në muajin pasardhës (janar 2014 - siç pretendon subjekti); (ii) të ardhurat e subjektit të përfituara nga orët jashtë orarit, kanë rezultuar të përfshira në analizën e kryer nga Komisioni, konkretisht të gjitha ato të cituara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vërtetimin e lëshuar prej saj, ku ishin të përfshira të gjitha të ardhurat nga paga dhe nga orët jashtë orarit. Megjithatë, Njësia e Shërbimit Ligjor ka rishikuar në analizën financiare të ardhurat të përfituara, konkretisht, në vitet përkatëse, sipas lëvizjeve bankare – të dhëna këto që përfaqësojnë përfitimin konkret dhe efektiv – nga ku ka rezultuar një përmirësim i balancës negative me 9,429 lekë, duke e reduktuar vlerën negative totale për periudhën e vlerësuar në shumën prej 646,838 lekësh.
50. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për prindërit e tij pensionistë, Komisioni ka vlerësuar se shpenzimet e jetesës të konsideruara në analizën financiare, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit²⁶, konsiderohen si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore, për rrjedhje, në mungesë së provës së kundërt, ky pretendim i subjektit nuk qëndron.
51. Lidhur me pretendimin e subjektit, për një përllogaritje jo të saktë të ditëve dhe shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, trupi gjykues konstaton se subjekti i referohet Udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013, të ministrit të Financave, si dhe VKM-së nr. 870, datë 14.12.2011, “Mbi trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, ndërkohë që Komisioni për llogaritjet në fjalë është bazuar në metodologjinë e vendosur nëpërmjet vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit, sipas së cilës konsiderohet shpenzimi prej 50 euro/dita. Për rrjedhje, nisur nga standardi, tashmë i vendosur mbi metodologjinë përllogaritëse të përdorur, vlerësohet se edhe ky pretendim nuk qëndron.
52. Lidhur me pretendimin e fundit të subjektit, sa i përket shpenzimeve të transportit për udhëtimet e tij drejt vendit të ushtrimit të detyrës, nga të cilat sipas tij, duhet të zbritet shuma 55,308 lekë në vitin 2016 dhe shuma 14,388 lekë në vitin 2015, si shumë kjo e llogaritur njëherë në shpenzimet jetike, trupi gjykues vlerëson se jemi në të njëjtat kushte, ku shpenzimet e jetesës së konsideruara në analizën financiare, në të cilën ndonëse janë të përfshira shpenzime mujore për transportin, ato referohen sërish si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore të së kundërtës. Ndonëse subjekti ka bërë me dije se përgjatë kësaj periudhe ka qenë i deleguar në gjykata të rretheve të tjera, për 24 çështje, për ndjekjen e të cilave transporti është kryer me mjetet e gjykatës, nuk ka paraqitur asnjë dokument provues lidhur me këtë pretendim dhe, përpos citimit të të gjithë shumës së përllogaritur për këto udhëtime, subjekti as nuk ka specifikuar/detajuar ndonjë

²⁶Vendimi nr. ***, datë 9.3.2021, sipas së cilit: “Shpenzimet bazike që përllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtyshme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore”.

vlerë konkrete të pa shpenzuar prej tij, për t'u zbritur nga shpenzimet e përlllogaritura për këtë qëllim.

53. Gjithsesi, ndonëse trupi gjykues i ka analizuar dhe argumentuar të gjitha pretendimet e subjektit lidhur me analizën financiare, vlen të theksohet fakti që, nisur nga vlera negative minimale e konstatuar nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ, nuk do të kishte asnjë ndikim në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë, si në rastin që do të mund të konsideroheshin të bazuara të gjitha pretendimet e subjektit, sikurse edhe nëse nuk do të çmohej i bazuar asnjëri prej tyre.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

54. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike, ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 (më poshtë) janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
55. Në analizën financiare që i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2013, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ prej 656,267 lekësh, e shpërndarë në tri vite, për të kryer të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara apo të konstatuara nga Komisioni, të cilat janë njoftuar si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ.
56. Në vijim të analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, paraqitur në prapësimet e dërguara prej tij, ka rezultuar një balancë negative e përgjithshme në vlerën 646,838 lekë.

Viti	2013	2014	2015	2016
PASURI	40 525	214 240	393 696	254 887
Automjet Mercedes Benz, C270				250 000
Ndryshim likuiditeti	40 525	214 240	393 696	4 887
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	40 525	254 765	648 461	653 348
DETYRIME	0	0	0	0
PASURI NETO	40 525	214 240	393 696	254 887
Të ARDHURA dokumentuar	1 205 341	1 327 055	1 332 899	1 223 887
Të ardhura të SR të vërtetuara	524 990	976 835	1 015 141	1 085 565
Të ardhura të nënës të vërtetuara	33 058	130 849	132 712	138 322
Të ardhura të babait të vërtetuara	185 081	184 589	185 046	0
Të ardhura të motrës të vërtetuara	462 212	34 782		
SHPENZIME	1 061 212	1 342 025	1 224 530	1 101 302
Shpenzime jetese	564 096	879 992	897 104	705 276
Shpenzime udhëtimi	77 116	42 033	92 226	157 736
Shpenzime siguracioni për automjetin				19 740
Shpenzime transporti			25 200	214 200
Shpenzime qiraje	420 000	420 000	210 000	
Shpenzime për ZVRPP				4 350
Analiza dokumentuar	103 604	-229 210	-285 326	-132 302
DIFERENCA E PA MBULUAR		-646 838		

57. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara, ku rezultoi që ai të ishte përfshirë. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se pas analizës financiare të përditësuar, pamundësia financiare minimale me burime të ligjshme, të shtrira përgjatë tri viteve nuk mund të përbëjë shkak për të konkluduar mbi për konstatimin e ndonjërit prej konstatimeve të nenit 33, pika 5, gjerat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016, ose ndonjë shkelje sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, apo për deklarim të mjaftueshëm, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

58. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 27.10.2017, në të cilin është shprehur se: *(i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.* Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, nga Grupi i Punës i DSIK-së, është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.7.2021, të KDZH-së.

59. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për një përditësim të informacionit, nga DSIK-ja fillimisht është përcjellë shkresa e datës 17.8.2021, nëpërmjet të cilës ka bërë me dije se edhe për periudhën pas raportit të lartpërmendur e deri në ditën e dërgimit të shkresës, nuk disponoheshin të dhëna mbi përfshirje të mundshme në aktivitete të kundërligjshme, të subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi.

60. Në vijim, nëpërmjet shkresave të datës 27.8.2021 dhe të datës 7.9.2021, DSIK-ja ka përcjellë në Komision të tjera informacione të organeve ligjzbatuese, nga të cilat ngrihen dyshime për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv, duke lehtësuar/favorizuar pozitën e të pandehurve. Në vijim të këtyre komunikimeve, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin, si dhe rishikimin e mundshëm të raportit fillestar të përcjellë për këtë subjekt rivlerësimi.

61. Gjithashtu, me shkresën e datës 5.11.2021, DSIK-ja ka bërë me dije se Grupi i Punës edhe në raportin e përditësuar me nr.*** prot., ka konfirmuar konstatimin fillestar për përshtatshmërinë e subjektit, duke e lënë në çmim të Komisionit një vlerësim të përgjithshëm të kriterit të figurës, lidhur me informacione të tjera që mund të disponoheshin përgjatë hetimit administrativ. Në vijim të kërkesës së Komisionit, me shkresën e datës 1.12.2021, DSIK-ja ka bërë me dije se edhe ky raport është deklasifikuar pjesërisht në datën 24.11.202 dhe ka përcjellë një kopje të tij.

62. Për një hetim administrativ, sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, është aksesuar në vendndodhjen e dokumentacionit të klasifikuar për t'u njohur me përmbajtjen e materialeve dhe informacioneve, mbi të cilat mbështeteshin dyshimet e lartpërmendura.

63. Përgjatë hetimit administrativ, në vijim dhe në funksion të të dhënave të dokumenteve dhe

të informacioneve të klasifikuara, janë kërkuar dhe, më pas, janë administruar disa vendime/akte/dosje gjyqësore që lidhen pikërisht me *indiciet* e referuara në këto materiale, të cilat janë analizuar dhe përshkruar në vijim. Konkretisht, Komisioni nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 20.9.2021, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe Kurbin, duke kërkuar që të përcilleshin pranë Komisionit disa akte dhe vendime gjyqësore, në lidhje me çështjet me të pandehur shtetasit: R. K. dhe Y. V.; F. Sh. dhe N. Sh.; E. D. dhe A. Gj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me shkresat nr. *** dhe nr. *** prot, të datës 4.10.2021, ka vënë në dispozicion kopje të dokumenteve të disponuara në lidhje me çështjet e kërkuara²⁷, nga shqyrtimi i të cilave ka rezultuar sa vijon:

1. Lidhur me vendimin nr. * , datë 2.11.2018**

64. Nga analiza e vendimit nr. *** , datë 2.11.2018, për çështjen penale me të pandehur shtetasit F. Sh. dhe N. Sh., të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ka qenë i deleguar nga ana e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues në këtë gjykim, subjekti ka mbajtur qëndrim pakice²⁸.
65. Gjithashtu, ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve për veprat penale “*kultivimi i bimëve narkotike*”, të parashikuar nga neni 283/2 dhe “*prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, të kryera në bashkëpunim dhe nën këtë akuzë ka kërkuar dënimin e të pandehurit F. Sh. me 7 vjet burgim dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm me 9 vjet burgim. Në lidhje me të pandehurën N. Sh., nën të njëjtën akuzë ka kërkuar dënimin e saj me 5 vjet burgim dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e saj me një dënim të vetëm me 7 vjet burgim.
66. Ndërsa, me vendimin nr. *** , datë 2.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka arsyetuar se nuk provohet që vepra e kultivimit të jetë kryer në bashkëpunim dhe ka vendosur: “*”Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të pandehurin F. Sh., nga ‘kultivimi i bimëve narkotike’, të kryer në bashkëpunim, në ‘kultivimi i bimëve narkotike’ të parashikuar nga neni 284/1 dhe dënimin e të pandehurit me 4 vjet burgim. Deklarimin e pafajshëm të tij për kryerjen e veprës penale ‘prodhimi dhe shitja e narkotikëve’, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, për shkak se i pandehuri nuk provohet ta ketë kryer veprën penale sipas parashikimit të nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimin me burgim për të pandehurin F. Sh., për një periudhë prove 5 vjet, me kushtin që ai të mbajë kontakte me zyrën vendore të shërbimit të provës Mat dhe të mos kryej vepër tjetër penale. Urdhërimin e lirim të menjëhershëm të të pandehurit F. Sh. nëse nuk mbahet për ndonjë masë sigurimi apo dënim tjetër penal të pa vuajtur. Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të pandehurën N. Sh., nga ‘kultivimi i bimëve narkotike’, neni 284/2 të kryer në bashkëpunim, në ‘kultivimi i bimëve narkotike’, të parashikuar nga neni 284/1 dhe dënimin e saj me 4 vjet burgim. Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të pandehurën N. Sh. nga ‘prodhimi dhe shitja e narkotikëve’, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, në ‘prodhimi dhe shitja e narkotikëve’ të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, dhe dënimin e saj në bazë të kësaj dispozite me 5 vite burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimin në fjalë për një periudhë prove 5 vjet, me kushtin*”

²⁷Në përgjigjen e dërguar në Komision, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka bërë me dije se nuk disponon vendime gjyqësore me palë shtetasit R. K. dhe Y. V. dhe kjo dosje është kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁸Në mbështetje të deklarinimit të tij në pyetëtorin nr. 2, lidhur me çështjen në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 7.12.2021, bashkëlidhur së cilës gjendet “mendimi i pakicës”, i dhënë prej tij.

që ajo të mbajë kontakte me zyrën vendore të shërbimit të provës Mat dhe të mos kryej veprë tjetër penale”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

67. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni, lidhur me qëndrimin e tij në këtë proces, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka sqaruar se ka mbajtur qëndrim pakice, me arsyetimin se rrethanat shëndetësore të prezantuara në gjykim nga ana e të pandehurit F. Sh., për mosaplikimin të nenit 59 të Kodit Penal, për të pandehurin, duhet të merreshin parasysh nga gjykata vetëm për të ulur dënimin (si rrethana lehtësuese), por jo për pezullimin e ekzekutimit të dënimit, sipas nenit 59 të Kodit Penal. Ndërsa për aplikimin e dënimit alternativ për znj. N. Sh., subjekti ka deklaruar se ka qenë dakord me shumicën për aplikimin e dënimit alternative ndaj saj, për shkak të moshës, gjinisë (femër) dhe rrethanave të tjera, rrethana të cituara në vendim. Referuar deklaramit të subjektit, por edhe konstatimeve të Komisionit përgjatë hetimit, ka rezultuar se vendimi në analizë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku dhe vijon të jetë në proces gjykimi.
68. Në lidhje me qëndrimin e mbajtur për sa i përket përjashtimit të rrethanës së bashkëpunimit, subjekti ka sqaruar se i pandehuri F. dhe e pandehura N., edhe pse janë bashkëshortë, ata kanë kryer veprimet e tyre, në mënyrë autonome, pa influencuar as mbi njëri-tjetrin në asnjë detaj të kësaj veprimtarie, as të lidhur si bashkëpunëtorë të një grupi që po hetohet ende nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë. Në mbështetje të arsyetimit të tij, subjekti ka cituar pjesë nga arsyetimi i vendimit ku evidentohet se: *“[...] Persona ende të pidentifikuar në mënyrë definitive (po hetohen nga Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, në kuadër të grupi të strukturuar kriminal) në kohën e mbjelljes, kanë kontaktuar të pandehurin F. Sh., duke i kërkuar këtij të fundit, që t’ua jepte atyre tokën, me qëllim mbjelljen dhe kultivimin e bimës narkotike Faktin e dhënies së tokës personave të tjerë, për qëllim kultivimin e bimës narkotike, i pandehuri F. Sh. ia ka bërë të ditur edhe bashkëshortes tij, të pandehurës N. Sh. [...]”.*
69. Subjekti ka shpjeguar se bazuar në rastet e ngjashme të mëparshme organi i akuzës, në rrethe të ndryshme, përgjithësisht për “punëtorët” (personat e përdorur dhe të paguar - nga financuesit, si krah pune për kultivimin e bimëve narkotike) e ka kualifikuar veprën penale lidhur me këtë kontribut, si “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe jo si “prodhim dhe shitje të narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal dhe dënimet e kërkuara dhe të aplikuara për ta, janë dënime minimale. Në kuptim të dënimeve alternative, sipas nenit 59 të Kodit Penal, subjekti ka deklaruar se ky vendim nuk është i formës së prerë, pasi është ankimuar nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë²⁹. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave, dokumentet si vijon:
- a) vendim nr. ***, datë 11.7.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
 - b) vendim nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shënimin përkatës që ka marrë formë të prerë;
 - c) vendimi nr. ***, datë 20.6.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka marrë formë të prerë më vendimin nr. ***, datë 6.3.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

²⁹Në shpjegimet dhe provat e dërguara në Komision, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sjellë për analogji qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. *** (***) , datë 20.6.2018, nga Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 6.3.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku arsyetohet se veprimet e të pandehurve të tjerë anëtarë të së njëjtës familje, nuk kualifikohen si bashkëpunim në kryerjen e veprës penale të “kultivimit të bimëve narkotike”, sipas nenit 284/2 të Kodit Penal, por janë veprime të kryera nga njëri prej anëtarëve të familjes, jo në bashkëpunim.

Vlerësimi i trupit gjykues

70. Referuar kuadrit ligjor të zbatueshëm, si dhe jurisprudencës së cituar, Komisioni vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje të subjektit apo dobësi në arsyetimin e vendimmarrjes së kësaj çështje. Ka rezultuar se shqyrtimi gjyqësor, vlerësimi dhe kualifikimi i fakteve, ka qenë brenda kuadrit të përcaktuar nga dispozitat penale, procedurale e substanciale. Gjithashtu, edhe vendimmarrja lidhur me masën e dënimit rezulton brenda marzheve të parashikuara nga dispozitat përkatëse. Edhe lidhur me konstatimin e gjykatës mbi mosekzistencën e bashkëpunimit midis dy të pandehurve, trupi gjykues çmon se edhe kjo rrethanë lidhet me vlerësimin e provave dhe fakteve dhe, për rrjedhojë, nuk mund të jetë objekt i mirëfilltë vlerësimi nga Komisioni, ndonëse argumentimi i gjykatës dhe shpjegimet e subjektit mbi këtë pikë nuk rezultojnë të paarsyetuara, madje përkojnë edhe me qëndrimet e tjera, në jurisprudencën e cituar.
71. Për rrjedhojë, Komisioni çmon se për sa kohë masat e dënimit janë dhënë brenda marzheve të përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse, mbetet në autoritetin diskrecional të gjykatës caktimi i masës konkrete të dënimit dhe nuk mund të jetë objekt vlerësimi nga organet e rivlerësimit, por vetëm nga gjykatat më të larta. Ky arsyetim mbështetet edhe në qëndrimet tashmë të konsoliduara të Kolegjit dhe, konkretisht, në vendimin (JR) nr. 28, datë 23.10.2020, në të cilin citohet se: “... masa e dënimit të caktuar prej gjykatës apo verifikimi i rrethanave që lidhen me urdhërimin për pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim, konsiderohen si elemente që lidhen me vlerësimin e rrethanave të faktit, rrezikshmërinë e autorit të veprës, vlerësimin e rrethanave rënduese e lehtësuese apo çdo treguesi tjetër që i vlen gjykatës për të individualizuar dënimin e dhënë për një vepër penale brenda marzheve të dënimit që parashikon ligji, të cilat çmohet se janë elemente që lidhen me korrektësinë e themelit, mbështetur në bindjen e brendshme të këtij disponimi të gjykatës, e cila nuk mund të shërbejë si një faktor që afekton vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit në kuptim të këtij procesi”. Kësisoj, Komisioni nuk ka evidentuar ndonjë shkelje konkrete apo favorizim të kryer nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje.
72. Nisur nga sa më sipër, në të njëjtën linjë do të argumentohet dhe konkludohet edhe në lidhje me zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, të aplikuar nga gjykata në këtë rast, për sa kohë – pa qenë nevoja e analizimit të prezencës, verifikimit apo aplikimit të drejtë të kriterëve formale që parashikon kjo dispozitë, nga gjykata (konkretisht dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues) – subjekti është distancuar nga aplikimi i kësaj dispozite në favor të shtetasit F.Sh., duke mbajtur një qëndrim pakice. Ndërkohë që e ka vlerësuar të aplikueshme këtë dispozitë për shtetasen N. Sh. edhe për shkak të gjinisë dhe rrethanave familjare.
73. Për sa më sipër, Komisioni rithekson se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështje gjyqësore, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit të formuar dhe të shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke kryer vlerësim dhe arsyetim mbi provat, si dhe mbi të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, mund të kryhet vetëm nga një tjetër gjykatë e legjitimuar dhe jo nga organet e rivlerësimit, të cilat duhet të konstatojnë shkeljet e mundshme procedurale, që mund të kenë pasjellë ndonjë favorizim, deformim faktik apo shkelje procedurale përgjatë shqyrtimit gjyqësor ose mungesë apo dobësi në arsyetimin e vendimmarrjeve përkatëse.

2. Lidhur me vendimin nr. ***, datë 2.11.2018

74. Nga shqyrtimi i këtij vendimi është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues në çështjen në të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit A. Gj., për veprat penale “kultivimi i bimëve narkotike”,

të parashikuar nga neni 283/2, dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim dhe “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim. Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm me 12 vjet burgim, duke i sugjeruar gjykatës të aplikojë uljen e dënimit në masën 1/3. Deklarimin fajtor të të pandehurit E. D., për veprat penale “kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/2, dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim, duke i kërkuar gjykatës të aplikojë uljen e dënimit në masën 1/3.

75. Ndërsa, gjykata ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Gj., për veprat penale ‘prodhimi dhe shitja e bimëve narkotike’, të parashikuar nga neni 283/1 dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim dhe ‘prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit’ të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm me 8 vjet burgim, për shkak të aplikimit të uljes së dënimit në masën 1/3, dënimin përfundimisht të tij me 5 vjet e 4 muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit E. D., për veprën penale ‘moskallëzim i krimit’, të parashikuar nga neni 300/1, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet e 3 muaj burgim, për shkak të aplikimit të uljes së dënimit në masën 1/3, dënimin përfundimisht të tij me 1 vit e 6 muaj burgim”.*
76. Vendimi në analizë ka rezultuar i ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila, ndër të tjera, ka arsyetuar se provohet jo vetëm dijenia e të pandehurit E. D., për mbajtjen nga i pandehuri tjetër të sasisë së lëndës narkotike, por edhe një kontribut konkret i tij në këtë aktivitet. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se deklaratimet e dëshmitareve të cilët janë ripyetur kanë fuqi të plotë provuese dhe janë në harmoni edhe me provat e tjera të ndodhura në dosjen e hetimit paraprak, pasi nuk janë kundërshtuar gjatë rritit të gjykimit³⁰, duke vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në këtë mënyrë: Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Gj., për veprat penale ‘prodhimi dhe shitja e bimëve narkotike’, të parashikuar nga neni 283/2 dhe dënimin e tij me 9 vjet burgim. lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin A. Gj., për veprën penale ‘prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit’ të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm me 10 vjet burgim, për shkak të aplikimit të uljes së dënimit në masën 1/3, sipas nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin përfundimisht të tij me 8 vjet e 6 muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit E. D., për veprën penale ‘prodhimi dhe shitja e bimëve narkotike’, të parashikuar nga neni 283/2 dhe dënimin e tij me 7 vjet e 6 muaj burgim, sipas nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin përfundimisht të tij me 5 vjet burgim”³¹.*

³⁰Gjykata e Apelit, ka vlerësuar se: (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka gabuar në vlerësimin se përgjigjet e kryera nuk e lidhin të pandehurin me mbajtjen e lëndës narkotike, por vetëm me dijeninë e ekzistencës së saj, pasi nga përgjimet ka rezultuar se i pandehuri dhe bashkëshortja e tij, pasi kanë marrë vesh se janë gjetur sende që i implikojnë ata të dy me vendin e ngjarjes, janë përpjekur për të gjetur një përgjigje të përbashkët për të shmangur përgjegjësinë e tyre; (ii) fakti që i pandehuri A. Gj. kishte lidhur një kontratë qiraje, tregon që kontaktet mes tyre kanë qenë të viteve të fundit. Ky fakt përputhet edhe me deklaratimet e dëshmitarit H. D., i cili ka deklaruar se vendi i ngjarjes (kontejneri) hapej dhe mbyllej nga i pandehuri E. D., së bashku me punëtorët që merrte. Ndërsa dëshmitari H. D., ka dëshmuar se në vendngjarje ka parë vetëm të pandehurin E. D.; (iii) ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e rrethit, deklaratimet e dëshmitareve harmonizohen me provat e tjera dhe tregojnë qartë edhe elementin kohë referuar kryerjes së veprës penale; (iv) deklaratimet e mëvonshme të këtyre shtetasve, dy ditë pas marrjes së masës së arrestit për të pandehurin E. D., krijojnë bindjen se ata nuk kanë shkuar me vullnetin e tyre përpara noterit, por janë orientuar për kryerjen e një veprimi të tillë dhe për rrjedhojë, nuk përbëjnë provë.

³¹Në vijim, kjo çështje është rekursuar në Gjykatën e Lartë dhe rekursi regjistruar në datën 19.7.2019, me nr. çështje ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

77. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk është provuar bashkëpunimi mes të pandehurve E. D. e A. Gj., për shkak se deklaratimet e personave, që kanë dijeni për veprën penale të shtetasve H. dhe H. D. nuk ishin të plota iu mungonte elementi kohë. Këto deklaratime ishin të karakterit të përgjithshëm, në raport me faktin penal, pasi: nuk evidentonin elementët dhe format e kontributit të të pandehurit E. D. në kryerjen e veprës penale; nuk evidentuan rolin, përgjegjësinë apo format e ndihmës, në kuptim të bashkëpunimit mes dy të pandehurve dhe nuk përputheshin me provat e tjera shkresore, që në të kundërt e shfaqësonin të pandehurin D. - siç është kontrata e qirasë e lidhur mes babait të tij dhe të pandehurit tjetër apo përgjimet e bisedave, që shprehin shqetësimet e bashkëshortes lidhur me pyetjen e saj, pasi në vendin e ngjarjes janë gjetur tekstet që ishin në emër të saj.
78. Gjithashtu, lidhur me mosekzistencën e provës mbi një bashkëpunim dhe, rrjedhimisht, mbi përgjegjësinë penale në këtë çështje të të pandehurit E. D., subjekti ka pretenduar se gjatë gjykimit gjykata ka konstatuar se i pandehuri E. D. ka qenë për shumë kohë në përgjim, pasi dyshohej se në bashkëpunim me shtetas të tjerë, si F. B. dhe Q. U., që merreshin me aktivitet kriminal në fushën e “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” dhe, për këtë arsye, është regjistruar edhe një tjetër procedim penal. Ai ka argumentuar se nga ana e prokurorisë nuk është paraqitur asnjë provë apo fakt, qoftë përgjime telefonike, ambientale, apo çfarëdo lloj prove tjetër, që të vërtetonte se i pandehuri E. D. ka biseduar, kontaktuar apo takuar, qoftë edhe një herë të vetme me të pandehurin A. Gj.
79. Subjekti ka pohuar se deklaratimet e dhëna nga personat që kanë pasur dijeni për rrethanat e veprës penale, duhet të vlerësohen pa i dhënë vlerë të paracaktuar, në kushtet kur janë dhënë nga persona, pa iu referuar elementit kohë dhe janë të një natyre të përgjithshme dhe nuk harmonizohen me prova të tjera, që të inkriminojnë drejtpërdrejtë të pandehurin E. D. në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. Për më tepër, duke vlerësuar dhe duke marrë në konsideratë faktin se këta persona (dëshmitarët) nuk janë çmuar të besueshëm nga gjykata, për sa kohë, nëpërmjet deklaratave të tyre noteriale të bëra përpara noterit, në një moment të dytë, pasi kishin dhënë dëshminë, kanë ndryshuar versionin e fakteve të njohura lidhur me këtë çështje.
80. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vendimi i mësipërm, edhe pse është ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, mbetet i bindur mbi mungesën e elementeve të mjaftueshëm të provuar për të konkluduar për një bashkëpunim midis dy të pandehurve, rrethanë kjo që mund të konfirmohet edhe nga Gjykata e Lartë nëse do të vlerësonte këtë dinamikë.
81. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentet si vijon:
- a) vendimi nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
 - b) vendimi nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë;
 - c) fletë e printuar nga sistemi elektronik i Gjykatës së Lartë, nga portali www.gjykataelarte.gov.al, në datën 17.3.2022, ora 4:55.

Vlerësimi i trupit gjykues

82. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e administruar lidhur me këtë çështje, në raport me *indiciet* e marra nga organet ligjzbatuese, si dhe vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti me shkrim edhe përgjatë seancës, duke evituar trajtimin e thelbit të vendimmarrjes, (për shkaqet e lartpërmendura në paragrafin 73), ndonëse nuk janë konstatuar shkelje procedurale specifike apo favorizime evidente të personave në gjykim, konsideron se në këtë rast mbeten disa dyshime të cilat mund të vlerësohen nga një tjetër organ që e ka këtë

kompetencë, mbi elementë që mund të përbëjnë shkaqe për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

83. Trupi gjykues, arrin në konkluzionin si më sipër, pasi vlerëson se – duke konsideruar faktin që gjendemi përballë një rasti të izoluar që nuk ka shkaktuar pasoja të pariparueshme, ku vlerësimi i subjektit mbi ekzistencën e një bashkëpunimi midis dy të pandehurve, ka qenë i kundërt me qëndrimin e Gjykatës së Apelit, që e ka rishikuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe, nga ana tjetër, duke mos qenë kjo rrethanë në vetvete e mjaftueshme për çuar në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, si të papërshtatshëm për të vijuar në funksionin e tij, apo të paaftë nga ana profesionale, apo për cenimin e besimit të publikut – bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se dosja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, lidhur me procedimin penal me nr. ***, akti të vitit 2017, duhet të përcillet pranë organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

3. Në lidhje me çështjen gjyqësore me të pandehur shtetasit R. K. dhe Y. V.

84. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin³² ka paraqitur në Komision dokumentacionin lidhur vendimin nr. ***, datë 18.7.2021, nga analiza e së cilit ka rezultuar se në çështjen penale nr. *** akti, me të pandehur shtetasit: Z. K. dhe Y. V., me objekt “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit Y. V. dhe deklarin fajtor të të pandehurit Z.K. dhe dënimin e tij me 12 muaj.
85. Pas ankimit nga palët, vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 24.1.2018. Në vijim³³, dosja gjyqësore penale që i përket vendimit nr. ***, datë 18.7.2021, i është përcjellë Gjykatës së Lartë.
86. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se i pandehuri Y. V. është përfaqësuar nga Avokati I. D.³⁴, i zgjedhur me prokurën e posaçme me nr. ***, datë 5.7.2017, ndërsa, i pandehuri Z. K., është përfaqësuar në gjykim nga av. J. K.
87. Ndërkohë është konstatuar se, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se kishte udhëtuar jashtë shtetit me destinacionin ***, Mali i Zi, për arsye turistike së bashku me shtetasit R. K. dhe J. K. Nisur nga sa më sipër dhe duke mbajtur në vëmendje informacionet e klasifikuara, si dhe dyshimin për gjykim në konflikt interesi janë kryer hetime dhe vlerësime të mëtejshme, por lidhur me analizimin e këtij fakti do të arsyetohet në mënyrë të detajuar në paragrafin mbi vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

88. Në shpjegimet e dhëna, lidhur me vlerësimin e tij mbi përgjegjësinë penale të të pandehurit Y. V., subjekti ka deklaruar se nga shqyrtimi gjyqësor, nuk është provuar pretendimi i organit të prokurorisë se ky i pandehur të kishte favorizuar kultivimin e bimëve narkotike. Nëpërmjet provave dhe *indicieve*, apo nga përgjimet telefonike të kryera ndërmjet personave të tjerë (pasi bisedat nuk janë kryer drejtpërdrejtë me të pandehurin) nuk ka rezultuar i provuar, as pretendimi tjetër dhe specifik i prokurorisë se i pandehuri nuk ka kryer asgjësimin e bimëve narkotike, apo nuk ka hartuar planet e masave, si dhe ka kryesuar grupet e kontrollit, në cilësinë e shefit të rendit, vetëm në një pjesë të parcelave, duke anashkaluar dhe lënë pa dokumentuar një pjesë të madhe të tyre. Si rrjedhojë e këtij

³²Me shkresën nr. *** prot., të datës 22.10.2021.

³³Sipas shkresës nr. *** prot., datë 3.4.2018, të paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁴Paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës “prokurë përfaqësimi të z. Y. V. nga av. I. D.”.

arsyetimi, subjekti ka vlerësuar se: “Sipas pikës ‘d’ të nenit 388 të Kodit të Procedurës Penale, jemi në kushtet e ekzistencës së veprës penale, e cila vërtetohet rregullisht, por nuk ka prova që të vërtetojnë në mënyrë të padyshimtë se atë e ka kryer i pandehuri Y. V., i legjitimuar në procesin gjyqësor nëpërmjet deklaramit dhe prokurës së posaçme”.

89. Ndërsa, në lidhje me masën e dënimit të aplikuar për të pandehurin Z. K., subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nuk u provua bashkëpunimi me kolegun e tij, apo me persona të tjerë të implikuar dhe, në përfundim, ka vendosur uljen e dënimit fillestar me 1/3 dhe dënimin e tij përfundimtar me 8 muaj burgim - në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanave të kryerjes, pasojave të ardhurave nga vepra penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret. Masa e dënimit është arsyetuar dhe argumentuar, me synim individualizimin e dënimit, sipas kërkesave të dispozitave penale, si dhe referuar në mënyrë orientuese qëndrimeve të Gjykatës së Lartë³⁵, ku përcaktohen elementët individualizues dhe matës të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Në përfundim, subjekti ka deklaruar se nuk ka synuar asnjëherë favorizimin e të pandehurit, për sa kohë ka vendosur deklarimin fajtor të tij, ndryshe nga sa ka kërkuar mbrojtësi i tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

90. Komisioni, pasi ka analizuar dokumentacionin e administruar, si dhe pasi ka marrë në shqyrtim shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, çmon se fakti i cilësimit të të pandehurit Y. V. si i pafajshëm, duke argumentuar se nga gjykimi nuk u provua fajësia, si dhe masa e dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Z. K., e cila ka rezultuar më e ulët nga ajo e kërkuar nga prokurori, lidhen me gjykimin dhe vlerësimin e themelit, që kryhet sipas bindjes së brendshme të trupës gjykuese, mbi analizën e provave të marra gjatë procesit dhe në kuptim e zbatim të ligjit material dhe zgjidhjes në thelb të çështjes, veprime këto që – sikurse është argumentuar edhe më sipër – mund të jenë objekt rivlerësimi vetëm nga një tjetër gjykatë dhe jo nga organet e rivlerësimit.
91. Në lidhje me faktin se subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit me avokatin J. K., i cili ka qenë palë në procesin gjyqësor të zhvilluar nga subjekti, Komisioni bazuar pikat 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, çmon se kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin substancial të këtij kontrolli, i cili konsiston në konstatimin e ekzistencës së mundshme të ndonjë kontakti të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal, që është konstatimi i plotësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së deklaramit përkatës. Për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, Komisioni ka kryer hetime për të verifikuar nëse shtetasit me të cilët subjekti ka udhëtuar apo ka pasur marrëdhënie të ndryshme (interesi apo shoqërore) ndonjëri prej tyre mund të rezultonte i përfshirë në krimin e organizuar, gjë e cila nuk ka rezultuar, duke konkluduar se nuk ekzistonte ndonjë kontakt i papërshtatshëm për këtë subjekt.
92. Ky konkluzion bazohet te raporti i DSIK-së dhe po ashtu edhe në përgjigjet e mbërritura nga SPAK³⁶, ku është konfirmuar se nuk ka rezultuar i regjistruar ndonjë procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të personave në fjalë.

Vlerësimi përfundimtar lidhur me çështjet e analizuar më sipër

93. Komisioni ka kryer një analizë të raportit të organeve ligjzbatuese, akteve të administruara, dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, duke kryer një vlerësim tërësor të rrethanave të verifikuara edhe çështjet konkrete të konstatuara nga hetimi administrativ, si dhe duke mbajtur në vëmendje qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit³⁷, i cili është shprehur

³⁵Udhëzimi nr. ***, datë 14.3.1979.

³⁶Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 21.12.2021.

³⁷Vendimi nr. 20, datë 8.9.2020, i Kolegjit, paragrafi 34.3.

se: “[...] është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional., në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale [...]”.

94. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo prova mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, për sa kohë edhe deklarimi i tij mbi kontrollin e figurës ka rezultuar e saktë, konkludohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

95. KLGJ-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2019, raportin e përpiluar nga ky institucion për analizimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi.
96. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
97. Sipas këtij raporti: (i) në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit; (ii) lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive; (iii) gjyqtari i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore; (iv) gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtarin Aurel Arapi është paraqitur 1 ankesë në vitin 2016, në ish-Inspektoratin e KLD-së. Ankesa e paraqitur është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor; (v) sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin Aurel Arapi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.
98. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi është eficient dhe efektiv në çështjet që ka shqyrtuar dhe ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara, ku rezultoi se gjykimet kanë përfunduar brenda afatit ligjor apo në respektim të afatit standard. Gjithashtu, subjekti ka

shfaqur të njëjtat aftësi për të kryer si duhet procedurat gjyqësore edhe në tri dokumentet ligjore të prezantuara prej tij, ku të gjitha gjykimet kanë përfunduar në respektim të afatit standard. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje, pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dy çështje civile themeli të vëzhguara, subjekti ka kryer rregullisht veprimet përgatitore, të cilat i ka dokumentuar rregullisht me procesverbal.

99. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Është konstatuar se komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Në dokumentet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Aurel Arapi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste që të ketë pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

100. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
101. Përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni³⁸, në lidhje me procedimet penale të mundshme të mosfilluara, pushuara apo pezulluara, si dhe në lidhje me ankesa të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se ndaj tij janë depozituar 4 kallëzime penale³⁹, të cilat trajtohen në mënyrë të detajuar më poshtë.
102. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 27.10.2020, ka bërë me dije se pranë saj kanë qenë të regjistruara 3 kallëzime penale⁴⁰ ndaj subjektit të rivlerësimit dhe ecuria e tyre ka rezultuar si në vijim.

1. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, datë 27.1.2017, për veprat penale “dhënie e vendimit të padrejtë” dhe “shpërdorim detyre”**

103. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 27.2.2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se nuk janë plotësuar elementet e figurës së veprës penale. Ky vendim është konsideruar i bazuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 2.5.2017.

2. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, datë 10.2.2020, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal**

104. Nga analiza e vendimit të administruar nga Komisioni lidhur me këtë çështje ka rezultuar

³⁸Kërkesë me nr. *** prot., datë 7.8.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁹Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2021, ka përcjellë informacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Shkodër.

⁴⁰Referuar shkresës nr. *** prot., datë 27.10.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 6.3.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 9.7.2021, ka bërë me dije se vendimi i sipërcituar ka rezultuar i ankimuar pranë kësaj gjykate nga “R. Bank” sh. a⁴¹.

105. Nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 24.9.2020, kjo gjykatë ka vendosur mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë Lezhë për mosfillimin e procedimit penal⁴². Në vijim, Gjykata e Apelit Shkodër, nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 7.12.2020, ka ndryshuar vendimin e mësipërm me konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. ***, datë 6.3.2020, të Prokurorisë dhe dërgimin e akteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

106. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka parashtruar se nga ana e tij gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje janë respektuar të drejtat procedurale të palëve, ato janë njoftuar rregullisht, janë caktuar ekspertët sipas procedurës. Subjekti ka deklaruar se ka dhënë shpjegime lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave⁴³.

3. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, datë 29.7.2020, për veprat penale “dhënie e vendimit të padrejtë” dhe “shpërdorim detyre”**

107. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni në lidhje me këtë ankesë ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale⁴⁴.

4. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, datë 29.1.2020, për veprat penale “dhënie e vendimit të padrejtë” dhe “shpërdorim detyre”, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**

108. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar lidhur me këtë kallëzim, Komisioni ka konstatuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***,

⁴¹Kërkesë nr. *** prot., datë 25.6.2021.

⁴²Nga analiza e dokumentacionit të administruar ka rezultuar se kallëzimi është bërë në lidhje me çështjen, me palë paditëse shoqëria “V.” sh.p.k. dhe palë të paditura shoqëria “T. B.” sh.p.k. dhe “R. Bank”, me objekt “deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv, kontratës së kredisë, kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, marrjen e masës për pezullimin e tyre”.

⁴³Kopje të fletëthirrjeve, kopje të procesverbaleve të seancave në datat: 19.3.2021; 28.4.2021; 2.5.2019; 3.6.2019; 13.6.2019; 28.6.2019; 22.7.2019; 31.7.2019; 18.8.2019; 23.8.2019; 27.8.2019; 12.9.2019; 17.9.2019; 27.9.2019; 4.10.2019; 14.10.2019; 21.10.2019; 24.10.2019; 31.1.2019; 4.11.2019; 16.12.2019; 18.12.2019; 13.1.2020; 4.2.2020; 27.2.2020; 22.6.2020; 26.6.2020; 25.8.2020; 10.9.2020; 15.10.2020; 26.11.2020; 24.12.2020; 19.3.2021; 28.4.2021. Kopje të dëftësave të komunikimeve, kopje të kërkesave të palëve dhe përfaqësuesve të tyre për shtyrje të seancave, kërkesë për shpallje të moskompetencës tokësore datë 24.12.2020; vendime të ndërmjetme “Për caktimin e detyrave për ekspertët” në datat 24.10.2019 dhe 31.10.2019; kërkesë e palëve të paditura datë 2.3.2020 për shkarkimin e ekspertës; pyetje shtesë të palës paditëse për ekspertin datë 4.2.2020; detyra shtesë të palës së paditur për ekspertin datë 27.1.2020; pyetje shtesë të palës paditëse për ekspertin depozituar në sekretari datë 28.1.2020; pyetje shtesë të palës paditëse për ekspertin depozituar në sekretari datë 28.1.2020; detyra shtesë të palës së paditur për ekspertin datë 27.1.2020; detyra për ekspertin të caktuar nga pala e paditur datë 12.10.2019; detyra për ekspertin të caktuar nga pala e paditur datë 31.10.2019; propozime për caktimin e ekspertëve të palës së paditur datë 16.10.2019; pyetje për ekspertët të propozuara nga pala paditëse; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 31.7.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm nr. ***, datë 22.7.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 31.7.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 25.8.2020; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 26.6.2020; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 18.8.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 27.8.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 17.9.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 4.11.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 16.12.2019; kopje të vendimit të ndërmjetëm datë 26.6.2020; kopje të vendimit përfundimtar nr. ***, datë 28.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës, si kopje të fletëthirrjeve, të procesverbaleve të seancave të mbajtura; të kërkesave të palëve lidhur me caktimin e ekspertëve; të vendimeve të ndërmjetme, si dhe të dispozitivit dhe të vendimit përfundimtar.

⁴⁴Komisioni i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me qëllim administrimin e vlerësimit të gjykatës në lidhje me këtë vendim. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., të datës 9.7.2021, gjykata ka bërë me dije se pranë saj nuk ka rezultuar i ankimuar vendimi me të dhënat e sipërcituara. Kërkesë nr. *** prot., datë 25.6.2021.

datë 21.2.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se nuk ekzistojnë kushtet ligjore për fillimin e procedimit penal. Komisioni i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴⁵ me qëllim administrimin e vlerësimit të gjykatës në lidhje me vendimin e prokurorisë me të dhënat e përshkuara më sipër. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 30.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka bërë me dije se pranë kësaj gjykate nuk ka rezultuar asnjë ankim në lidhje me vendimin e sipërcituar.

109. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga Prokuroria e Përgjithshme është bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar të regjistruara 2 ankesa⁴⁶, të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim.

5. Në lidhje me ankesën nr. * prot., të vitit 2018, nga shtetasi P. N.**

110. Komisioni ka administruar dokumentacionin dhe vendimet gjyqësore për çështjen objekt ankimi, depozituar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas shkresës nr. *** prot., datë 5.6.2018. Në vijim, kjo ankesë është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ankuesi ka pretenduar se në mënyrë të padrejtë, subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 27.9.2018, ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 13.4.2018 për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2018, me arsyetimin se veprimet hetimore verifikuese të kryera nga policia gjyqësore kanë qenë të plota. Ai është bërë palë me prokurorin e çështjes dhe me krimin.

111. Nga analiza e vendimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se vepra penale, objekt kallëzimi është kryer para datës 10.4.2014 dhe sipas parashikimit të germës “dh”, të pikës 1, të nenit 290, veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal (objekt kallëzimi), i është dhënë amnisti, për rrjedhojë, kjo vepër nuk mund të ndiqet penalisht. Ai ka referuar për analogji paragrafin 22 të vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku citohet se: “[...] *Vendimi i prokurorit që ka disponuar mosfillimin e procedimit penal merret pasi më parë janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale [...]*”.

112. Duke pasur parasysh se në germën “dh” të nenit 290, një ndër rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit është dhënia e amnistisë për atë lloj vepre penale, si dhe në nenin 2 të ligjit nr. 92/2015, “Për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014, ‘Për dhënie amnistie’”, i cili ka hyrë në fuqi më 22.8.2015, ku parashikohet: “[...] *Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10.4.2014*”, subjekti ka vlerësuar se vepra është amnistuar dhe, për rrjedhojë, ka lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal, siç është përshkruar më sipër.

113. Vendimi i dhënë nga subjekti është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër⁴⁷, e cila me vendimin nr. ***, datë 27.12.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.9.2018, me arsyetimin se pretendimet e ankuesit çmohen të bazuara pasi vendimi i organit të prokurorisë, i marrë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, ka ardhur si rezultat i interpretimit jo të drejtë dhe të pabazuar të ligjit penal dhe atij procedural penal dhe është rrjedhojë e një hetimi jo të plotë, prandaj duhet të ndryshohet duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuësve, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore

⁴⁵Referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.9.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁴⁶Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 30.9.2020, ka përcjellë informacionin pranë Komisionit.

⁴⁷Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 7.9.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vënë në dispozicion të Komisionit vendimin nr. ***, datë 27.12.2018.

nga organi i prokurorisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

114. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna për Komisionin, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ka pretenduar se nga aktet e administruara në fashikullin e këtij procedimi penal rezultoi e provuar se Prokuroria ka realizuar një hetim të plotë, të gjithanshëm dhe objektiv, prandaj ka vendosur lënien në fuqi të tij.
115. Subjekti ka theksuar se kallëzimi i bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në vijim ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe, më pas, në Gjykatën e Apelit Shkodër, ka pasur për objekt veprimtarinë hetimore të kryer nga një subjekt tjetër rivlerësimi, konkretisht, e prokurorit z. B. Sh. Subjekti ka vlerësuar se hetimet e tij kanë qenë të plota dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit, të dhënë nga ky prokuror. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- a) vendimin nr.***, datë 27.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
 - b) vendimin nr.***, datë 27.12.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vlerësimi i trupit gjykues

116. Trupi gjykues, pasi ka shqyrtuar materialin e disponuar, vlerëson se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Apelit Shkodër, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur subjekti i rivlerësimit. Ky fakt, ndonëse mund të mbahet në konsideratë nga Komisioni, në një vlerësimin të përgjithshëm çmohet se nuk përbën as shkelje procedurale dhe as mangësi profesionale të subjektit, për sa kohë vlerësimi lidhet me themelin e çështjes dhe bindjen e brendshme që çdo vendimmarrës mund të krijojë, si të bazuar mbi një logjikë analitiko-juridike⁴⁸. Trupi gjykues vëren se as janë evidentuar nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe as nuk janë konstatuar nga Komisioni shkelje konkrete procedurale apo dobësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti, të cilat mund të kualifikoheshin si mangësi në aftësitë profesionale të tij. Gjithashtu, edhe duke iu referuar metodologjisë së vlerësimit periodik të magistratëve, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, vërehet se nuk parashikohet si instrument matës i aftësive për gjykim apo arsyetim ligjor të tyre, qëndrimi që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet përkatëse të subjekteve nën vlerësim profesional.

6. Në lidhje me ankesën nr. * prot., të vitit 2018, nga shtetasi G. K., të depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj subjektit të rivlerësimit**

117. Nga dokumentacioni i paraqitur nga prokuroria në lidhje me këtë ankesë ka rezultuar se ankuesi nuk ka referuar çështje konkrete të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit dhe as nuk ka paraqitur prova mbi pretendimet e tij.
118. Gjithashtu, është konstatuar se ankesa në fjalë është arkivuar nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe sikurse është bërë me dije nga ky institucion, ankuesit i është komunikuar/sqaruar se në lidhje me pretendimet e tij mund t'i drejtohej Gjykatës së Apelit.

⁴⁸Në rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [datë 17.11.2010 CM/Rec (2010)12], "Mbi pavarësinë dhe eficientën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve", në kreun VII ku trajnohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, përcaktohet se: "Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. [...] Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë. [...]"

Shihni "Komentarin mbi parimet e Bangalores mbi etikën e gjyqtarëve" (sekreti profesional dhe imuniteti i gjyqtarëve): https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf

7. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasit R. K. dhe Y. V. – të trajtuar pjesërisht edhe në paragrafin e kriterit të kontrollit të figurës – vijohet këtu për sa i përket analizimit dhe vlerësimit mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit.

119. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se z. J. K. – (lidhur me të cilin më herët kishte deklaruar se kishte kryer një udhëtim), është i njëjti person me av. J. K., i cili ka qenë në rolin e mbrojtësit të njërit prej të pandehurve në çështjen e sipërcituar. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se nuk ka asnjë marrëdhënie familjare apo shoqërore të theksuar me z. J. K., pasi njohja me këtë ka qenë shumë rastësore dhe udhëtimi ka qenë i paplanifikuar prej tij⁴⁹ me atë, por me z. R. K., që ishte një njohje e përbashkët. Pra, ky udhëtim ka qenë rastësor dhe ka zgjatur vetëm 5 orë, me destinacion qytetin ***, në Mal të Zi.
120. Subjekti ka argumentuar, gjithashtu, se njohja e tij rastësore me këtë avokat nuk ka ndikuar në kryerjen e detyrës dhe vendimmarrja e tij, në çështjen në fjalë, ka qenë e mbështetur në ligj dhe në prova. I pandehuri Z. K. (që mbrohej nga av. J. K.) nuk është favorizuar në asnjë rast në këtë gjykim. Ai është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar. Në vijim, vendimi i dhënë nga subjekti është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 24.1.2018, për të pandehurin Z. K., ndërsa për të pandehurin Y.V. është vendosur mospranimi i ankimit.
121. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit, referuar përcaktimeve të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka deklaruar mungesën e çdolloj konflikti interesi me shtetasin J. K., gjatë ushtrimit të detyrës prej tij, si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin apo edhe në gjykatat e tjera ku ka qenë i deleguar për gjykim të çështjeve të caktuara, pasi sipas tij mungon interesi faktik që të ketë ndikuar apo mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi shtetërore.

Vlerësimi i trupit gjykues

122. Nisur nga sa më lart dhe në vlerësim të rrethanave të njohura, trupi gjykues vlerëson se nuk nuk plotësohen kushtet e ekzistencës së një marrëdhënieje të tillë për të përbërë konflikt interesi. Ky vlerësim mbështetet në këto fakte: (i) udhëtimi ka qenë i vetëm, i shkurtër dhe së bashku me një person të tretë që ka poseduar dhe drejtuar edhe mjetin e përdorur; (ii) njohja/udhëtimi ka qenë me një avokat mbrojtës dhe jo direkt me një palë në proces; (iii) nuk është provuar ndonjë influencim apo favorizim nga subjekti ndaj të pandehurit të mbrojtur nga av. J. K. Përkundrazi, ka rezultuar që pikërisht i pandehuri Z. K., i mbrojtur nga ky avokat është dënuar nga subjekti, ndërkohë që i bashkëpandehuri tjetër, (Y.V.), i mbrojtur nga një tjetër avokat, është deklaruar i pafajshëm po nga subjekti me të njëjtin vendim; (iv) vendimi në fjalë është lënë tërësisht në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit.
123. Gjithashtu, Komisioni i ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha rastet e përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2021, që ka vënë në

⁴⁹Udhëtimi është realizuar me automjetin me targa ***, të drejtuar nga shtetasi R.K., ka dalë nga PKK M*** më 15.10.2016, ora 22:14 dhe ka hyrë në PKK H*** H*** më 16.10.2016, ora 03:15. I pyetur nga Komisioni në lidhje me marrëdhënien mes shtetasve R. K. dhe av. J. K., subjekti ka deklaruar se midis tyre ka marrëdhënie shoqërore si dhe krushqia me familjarët e tyre (nipër/mbesa), pasi janë të dy me të njëjtën origjinë nga Qarku i Lezhës. Subjekti ka deklaruar se me z. R. K., av. J. K. kishte njohje të mëparshme. Subjekti ka deklaruar gjithashtu, se nuk ka pasur akt përdorimi të automjetit. Automjeti në pronësi të shtetasit F. Gj., mik familjar i shtetasit R. K., është drejtuar nga ky i fundit. Subjekti ka deklaruar mungesën e çdolloj konflikti interesi shtetasit e sipërcituar, si dhe me pronarin e automjetit, shtetasin F. Gj., gjatë ushtrimit të detyrës. Ai ka bërë me dije se këtë të fundit e njeh si pronar të një biznesi të ndodhur në M**, lokal “*****”, në të cilën ai ka shkuar për një ceremoni martesore. Av. J. K., në cilësinë e avokatit në Dhomën e Avokatisë Tiranë, ka përfaqësuar çështje civile apo penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në të cilat subjekti ka qenë gjyqtar.

dispozicion 11 vendimet për çështjet e gjykuara nga subjekti ku shtetasi J. K. ka qenë mbrojtës (por jo në të gjitha) në disa nga proceset gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit. Po ky institucion, me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2021, gjithashtu ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti me palë shtetasit R.K. dhe F.G.

124. Nga analiza e vendimeve të përcjella dhe të administruara pranë Komisionit ka rezultuar se 10 prej tyre janë të njëjta me ato të vëna në dispozicion edhe nga subjekti i rivlerësimit⁵⁰ (me përgjigjet e dërguara për pyetësonin nr. 4), të cilat janë analizuar në vijim. Ndërsa, lidhur me një tjetër vendim të mbërritur në Komision, konkretisht atë me nr. ***, datë 23.5.2017, pas konstatimit se ai nuk është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, por nga gjyqtari A. Gj., kjo çështje nuk i është nënshtruar shqyrtimit nga Komisioni.

1. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 16.12.2020**, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin ndaj të miturit në konflikt me ligjin, shtetasit A. Xh., i përfaqësuar nga av. J. K.

125. Nga analiza e këtij vendimi ka rezultuar se kjo çështje penale është gjykuar në trup gjykues me tre anëtarë, e kryesuar nga subjekti i rivlerësimit. Me vendimin nr. ***, datë 16.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur deklarinimin fajtor të të miturit A. Xh., për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga germa “a” e nenit 79 dhe duke e dënuar atë me 10 vjet burgim.

126. I mituri në konflikt me ligjin ka kërkuar nëpërmjet avokatit të tij gjykimin e shkurtuar dhe pavarësisht se prokurori i çështjes nuk ka qenë dakord me këtë kërkesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin e ka pranuar atë – dhe në përfundim ka vendosur deklarinimin fajtor të të miturit dhe dënimin e tij me 10 vjet burg, për shkak të gjykimit të shkurtuar, dënimi përfundimtar ka qenë me 6 vjet e 8 muaj burgim.

127. Komisioni ka administruar përgjatë procesit të rivlerësimit edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë⁵¹, e cila e ka konsideruar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, të marrë në mosrespektim të dispozitave procedurale penale dhe, për këtë arsye, duhet të prishet dhe të gjykohet sërish nga e njëjta gjykatë e rrethit, me një tjetër trup gjykues. Sipas kësaj gjykate, në çështjen në fjalë, vetëm pasi të ishte kryer procedura e gjykimit të zakonshëm mund të procedohej me dënimin sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, dhe kësaj nuk duhej që të ishte pranuar kërkesa për gjykimin e shkurtuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

128. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ka dhënë shpjegimet e tij duke parashtruar disa argumente kundërshtuese lidhur me faktin e ndryshimit të vendimit të tij nga Gjykata e Apelit, duke parashtruar argumentet në vijim.

129. Në datën 1.1.2018 ka hyrë në fuqi ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ngjarja ka ndodhur. Duke qenë se procesi gjyqësor penal është zhvilluar ndaj një të mituri në konflikt me ligjin, në referim të nenit 5 të ligjit të sipërcituar (KDPM), si një *lex posteriori* dhe *lex specialis* në këtë rast, ku citohet se: “Dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur, vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga KDPM-ja ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit”,

⁵⁰Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: vërtetimin nr. ***, datë 7.12.2021, të Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Kurbin. dhe 10 vendimet e sipërcituara, me shënimet përkatëse të Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵¹Me shkresën nr. *** prot., datë 11.1.2022, ka përcjellë vendimin nr. ***, të datës 23.11.2021.

subjekti ka vlerësuar të marrë në konsideratë këtë parashikim ligjor në vendimmarrjen e tij lidhur me çështjen në analizë.

130. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex speciali derogat legi generali*). Gjithashtu, norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme (*lex posteriori derogat legi priori*)⁵². Këto dy rregulla, si dhe përparësia që ka KDPM-ja ndaj Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, janë cilësuar me rëndësi në rastin konkret nga subjekti, për shkak se, sipas pikës 2, të nenit 97, të KDPM-së, për të miturin në konflikt me ligjin, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se 12 vjet.
131. Në lidhje me pranimin e kërkesës së gjyqimit të shkurtuar, subjekti ka deklaruar se në arsyetimin e vendimit nga ana e tij është mbajtur në konsideratë përcaktimi i pikës 2, të nenit 403, të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, hyrë në fuqi më 31.7.2017, sipas të cilit *nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*. Duke qenë se vrasja e viktimës ka ndodhur më 5.9.2018, ky ndalim ligjor, në parim, gjente zbatim edhe në rastin konkret.
132. Ndalimi i dënimit të të miturve me burgim të përjetshëm, parashikohet edhe në pikën 2, të nenit 31, të Kodit Penal, sipas të cilit: *“Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç ...”*. Në kuptim të këtij neni, të lidhur me nenet 5 dhe 97, pika 2, të KDPM-së, nuk mund të gjejë zbatim pika 2, e nenit 403, të Kodit të Procedurës Penale, në rastin kur autori i dyshuar i veprës penale është i mitur. Për këtë arsye, subjekti ka vlerësuar se ky nen i Kodit të Procedurës Penale nuk përbën pengesë për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, për sa kohë kjo kërkesë është paraqitur nga një i mitur në konflikt me ligjin. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- a) vendimin nr. ***, datë 16.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me shënimin se është ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 23.11.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë;
 - b) fletë e printuar nga sistemi elektronik i Gjykatës së Lartë, nga portali www.gjykataelarte.gov.al, më 17.3.2022, ora 14:36;
 - c) shkresa nr. *** prot., datë 24.12.2021, e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Vlerësimi i trupit gjykues

133. Pas analizimit të vendimit të sipërcituar të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shpjegimeve të paraqitura prej tij, në mënyrë të përmbledhur përshkruhen disa elemente vlerësuese dhe argumentuese të dinamikës procedurale të kësaj çështjeje, duke mbajtur në vëmendje edhe faktin se për shkaqet e përmendura edhe më herët, Komisioni nuk mund të vlerësojë apo zëvendësojë logjikën e përdorur nga gjykata dhe as mund të analizojë/çmojë provat apo thelbin e vendimmarrjes.
134. Përpos konstatimit se Gjykata e Apelit e ka ndryshuar vendimin e dhënë nga gjykata e rrethit, nga ku evidentohet një interpretim i ndryshëm i mënyrës dhe radhës së aplikimit të disa dispozitave ligjore (konkurruese), Komisioni e nis analizën nga citimi i vendimit unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, të Gjykatës së Lartë, në të cilin parashikohet se: *“b. [...] kërkesën e të dënuarit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor [...]”*. Ndonëse nuk ka qenë kjo rrethanë objekt vlerësimi

⁵²Shihni vendimet: nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 16, datë 27.3.2012 dhe nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

dhe interpretimi (të ndryshëm) nga gjykatat e lartpërmendura, duhet theksuar se shqyrtimi paraprak i kësaj kërkesë përbën arsyen që në nenin 403/2 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se kërkesa depozitohet të paktën tri ditë përpara datës së caktuar për seancë, ose përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, duke i dhënë kështu mundësi gjykatës që të vlerësojë se si duhet të procedojë me tej në gjykimin e çështjes. Gjithashtu, vlen të evidentohet se në interpretim të pikës 6, të nenit 404, të Kodit të Procedurës Penale edhe konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për pranimin e gjykimin të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

135. Nga ana tjetër, legjislatori për këtë lloj gjykimi ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403 - 406), për gjykimin e posaçëm. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 4, datë 10. 2. 2012, të saj, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] *përdorimi i rregullave të përgjithshme të gjykimin të zakonshëm në gjykimin e posaçëm bëhet, në mënyrë taksative, vetëm në rastet kur këtyre rregullave u referohen në mënyrë eksplicite dispozitat e veçanta të gjykimin të shkurtuar [...]*”.
136. Duke u rikthyer në rastin konkret dhe, konkretisht, te dispozita që ka pasur një interpretim të ndryshëm, lidhur me sa më lart ndërthuret edhe efekti i dispozitës që përshkruhet në nenin 403/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet në mënyrë eksplicite se “[...] *Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm [...]*”. Por, nga ana tjetër, nëse në rastin specifik – në bazë të parimit se ligji i posaçëm ka përparësi aplikimi ndaj ligjit të përgjithshëm (konkurrues) – çmohet i aplikueshëm kufizimi i dënimit maksimal në 12 vjet burg, në bazë dhe sipas pikës 2, të nenit 97, të KDPM-së – që parashikon se: “... *për të miturin në konflikt me ligjin, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se 12 vjet*” – atëherë kjo masë dënimi nuk mund të konsiderohet në vetvete si një pengesë për aplikimin gjykimin të shkurtuar, pikërisht sepse në këtë rast nuk gjendet përballë një dënimi maksimal (ndonëse hipotetik), me burgim të përjetshëm, por me një maksimum dënimi të aplikueshëm, të kufizuar në 12 vjet burg, pikërisht nga dispozita e veçantë. Gjithsesi, ndonëse kjo temë mbetet objekt interpretimi dhe, për rrjedhojë, ndoshta, gjykata e rrethit mund edhe të kishte vepruar sikurse është shprehur Gjykata e Apelit – nga një vlerësim i rrethanave dhe dinamikave më sipër, nuk mund të evidentohet ndonjë shkelje konkrete procedurale e kryer nga subjekti, për sa kohë nuk rezulton të ekzistojë asnjë dispozitë ligjore apo përcaktim/qëndrim jurisprudencial që të unifikojë dhe qartësojë renditjen e përparësisë midis përcaktimit paraprak të kufirit maksimal të dënimit të parashikuar nga pika 2, e nenit 97, të KDPM-së, me efektet pasuese mbi ritin etj., apo pikënisjen e detyrueshme nga dënimi maksimal i përgjithshëm, me pasojë aplikimin e përjashtimit të gjykimin të shkurtuar sipas nenit 403/2 të Kodit të Procedurës Penale.
137. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë rrethanat specifike dhe zgjidhjet e mundshme përkatëse mbi aplikimin e dispozitave procedurale të lartpërmendura janë çështje dhe zgjedhje të interpretueshme, të cilat, në këtë stad, nuk mund të përkufizohen si të gabuara edhe për shkak të mungesës së një rregullimi qartësues dhe orientues, nëpërmjet një jurisprudence unifikuuese nuk mund të konkludohet në këtë rast për ekzistencën e ndonjë shkeljeje procedurale të kryer prej subjektit të rivlerësimit apo për mangësi të aftësive të tij profesionale, lidhur me këtë çështje.

2. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 29.1.2021**, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të pandehur N. B., hetuar në mungesë, i përfaqësuar në gjykim nga av. J. K.

138. Nga analiza e vendimit ka rezultuar se i pandehuri ka qenë i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 297 i K. Penal”, ku është vendosur: “*Pranimin e kërkesës së Prokurorit, si të bazuar në prova dhe në ligj dhe dërgimin në gjyq të çështjes penale Nr.***, të vitit 2020*”. Për rrjedhojë nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrejë dyshime për shkeje procedurale apo ndonjë favorizim i palës së mbrojtur nga av. K.

3. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 18.7.2017**, që i përket kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të pandehurit Z. K. dhe Y. V.

139. Ky vendim është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe i pandehuri Z.K. Në vijim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 24.1.2018, për të pandehurin Z. K., ndërsa për të pandehurin Y. K. është vendosur mospranimi i ankimit dhe çështja është në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë Tiranë. Kjo çështje është trajtuar më lart.

4. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 4.3.2021**, me palë paditëse M. B. e përfaqësuar nga av. J. K. dhe të paditur A. B., me objekt “zgjidhje martese”, ku është vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrenë dyshime për shkelje procedurale apo ndonjë favorizim i palës së mbrojtur nga av. J. K.

5. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 16.2.2021**, me palë paditëse O. Xh. dhe të paditur, Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative M***, me objekt “deklarim i pasaktë i rubrikës datëlindje”.

140. Me këtë vendim është vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Nga analiza e vendimit të sipërcituar ka rezultuar se në këtë çështje avokate ka qenë shtetasja G. B. dhe jo shtetasi J. K. Gjithsesi nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrenë dyshime për shkelje procedurale apo për ndonjë favorizim.

6. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 25.2.2021**, me palë paditëse H. P. dhe të paditur I. P., me objekt “zgjidhje martese”.

141. Me këtë vendim është vendosur pranimi i kërkesëpadisë. Vendimi ka marrë formë të prerë, më 13.3.2021, duke mos u ankimuar nga palët, referuar shënimit përkatës të kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Gjithashtu edhe në lidhje me çështjen e sipërcituar, ka rezultuar se avokate ka qenë shtetasja G. B. dhe jo shtetasi J. K. Gjithsesi, as këtu nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrenë dyshime për shkelje procedurale apo për ndonjë favorizim.

7. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 16.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin**, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe persona nën hetim N.V. (B.F.), Gj. (G.) F. dhe R. (S.) F., me objekt “vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”.

142. Nëpërmjet këtij vendimi, për personin nën hetim N. V. (B. F.) është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, me afat 30-ditor dhe për personat e tjerë nën hetim Gj. (G.) F. dhe R. (S.) F., masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Të pandehurit kanë qenë të mbrojtur në gjykim nga av. J. K. Masa e sigurimit nuk është ankimuar nga asnjë nga palët dhe ky vendim ka marrë formë të prerë. Nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrenë dyshime

për shkelje procedurale apo për ndonjë favorizim.

8. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 14.5.2021**, me kërkues: N. V. (F.), palë e interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “zëvendësim mase sigurimi”, me të cilin është vendosur: “mospranimi i kërkesës”, për shkak të heqjes dorë prej kërkuesit dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

9. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 21.9.2021**, me palë paditëse I. P. përfaqësuar në gjykim nga av. J. K. dhe të paditur P. P., me objekt “zgjidhje martese”, ku është vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë, më 13.10.2021, duke mos u ankimuar nga palët. Nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrenë dyshime për shkelje procedurale apo për ndonjë favorizim.

10. Në lidhje me vendimin nr. *, datë 14.5.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin**, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin kundër personit nën hetim N.V. (B. F.), me objekt caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”.

143. Me këtë vendim gjykata ka vendosur caktimin e një mase më të lehtë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga nenet 232/b dhe 234 të Kodit të Procedurës Penale. Në vijim, masa e sigurimit, e caktuar nga gjykata është ankimuar nga organi i akuzës dhe është ndryshuar me vendimin nr.***, datë 7.7.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Nëpërmjet shkresës nr.*** prot., datë 17.12.2021, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me qëllim administrimin e vendimit nr. ***, datë 7.7.2021. Nga shqyrtimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2021, ka rezultuar se ndryshe nga gjykata e rrethit, nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra është vlerësuar se masa e sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, është e papërshtatshme për personin nën hetim. Ajo ka arsyetuar se gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që paraqet rasti konkret, pasojat e ardhura dhe rrethanat e kryerjes së veprës, si dhe faktin që personi nën hetim e ka kryer veprën menjëherë pasi ai është shoqëruar në polici, duke bashkëpunuar me persona të tjerë dhe duke vënë punonjësin e policisë në një situatë të kërcënuar për jetën dhe shëndetin. Në përfundim, Gjykata e Apelit referuar pikës 2, të nenit 229, të Kodit të Procedurës Penale dhe bazuar në kriterin e posaçëm të përcaktuar në pikën 1, të nenit 230, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur se çdo masë tjetër veç asaj të arrestit në burg është e papërshtatshme, duke ndryshuar në këtë mënyrë vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

144. Subjekti ka pretenduar se vendimi i marrë prej tij është një vendim i bazuar në prova dhe në ligj, në përputhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, për shkak se janë zbutur nevojat e sigurimit, në raport me rëndësinë e faktit, në raport me momentin fillestar të caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, me afat 30-ditor⁵³.

⁵³Masa e mëparshme është caktuar me vendimin nr. ***, datë 16.4.2021, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe persona nën hetim N. V. (B. F.), Gj. (G.) F. dhe R. (S.) F., me objekt “vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, ku për personin nën hetim N. V. (B. F.) është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, me afat 30-ditor, duke mos kryer asnjë favorizim ndaj personit nën hetim dhe për personat e tjerë nën hetim Gj. (G.) F. dhe R. (S.) F., masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, pasi këta dy personat e tjerë nuk kanë rezultuar të përfshirë në ngjarje. Masa e sigurimit nuk është ankimuar nga asnjë nga palët, as nga personat në hetim dhe as nga prokurori dhe ky vendim ka marrë formë të prerë më 21.4.2021, referuar shënimit përkatës të kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

145. Subjekti ka deklaruar se përveç faktit se kanë ndryshuar rrethanat e faktit në raport me masën e sigurimit personal shtrenguese “arrest në burg”, me afat 30-ditor, si dhe për shkak se më 4.5.2021 është realizuar normalizimi i marrëdhënieve mes personit nën hetim me viktimën, që përbën rrethanë lehtësuese në kuptim të nenit 48/germa “e” të Kodit Penal dhe nenit 229 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, duke zvogëluar rrezikshmërinë shoqërore të personit nën hetim dhe të veprave penale, të dyshuara të kryera prej tij, si dhe faktin që ai nuk ka qenë dënuar më parë. Në vijim, masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, u ankimua nga organi i akuzës dhe u ndryshua me vendimin nr. ***, datë 7.7.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”⁵⁴.
146. Subjekti ka deklaruar se personi nën hetim N.V. është përgjegjës për kujdesjen dhe përmbushjen e detyrimeve familjare, bashkëjetuesja e tij është shtatzënë në muajin e fundit dhe pret të lindë fëmijën në datën 28.5.2021. Gjykata ka çmuar të theksojë parimin e interesit më të lartë të fëmijës, që duhet të jetojë në një ambient familjar dhe me kushte ekonomike e shëndetësore të përshtatshme për të, ku vijimi i personit nën hetim N. V. (B.F.) në masën e sigurimit “arrest me burg”, do të ndikonte shumë edhe në psikologjinë e nënës.
147. Po ashtu, subjekti ka argumentuar edhe normalizimin e marrëdhënieve me viktimën (dëmtuarin) shtetasin D. M., që përbën rrethanë lehtësuese në kuptim të nenit 48/germa “e” të Kodit Penal dhe neni 229 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, duke zvogëluar rrezikshmërinë shoqërore të personit nën hetim e të veprave penale, të dyshuara të kryera prej tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

148. Trupi gjykues, pa dashur të vlerësojë mbi bindjen e brendshme dhe diskrecionit të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket vlerësimit dhe caktimit të llojit të masës së sigurisë personale, duke marrë në konsideratë shpjegimet e tij dhe rrethanat konkrete, ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë – konkretisht, në vendimin unifikues nr. 7⁵⁵, datë 14.10.2011, të saj ndër të tjera arsyetohet se: “[...] ... nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2, të nenit 229, të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të të pandehurit, nëse ka precedentë penalë, mënyrën

⁵⁴Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka listuar provat e administruara prej tij përgjatë gjykimit, mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja në fjalë: “*Certifikatë personale e znj. E. H., datë 16.6.2016, e lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. *** Tiranë; ekzaminime të znj. E. H. pranë Spitalit Amerikan, datë 27.4.2021, e cila rezulton shtatzënë dhe data e lindjes vlerësohet 28.5.2021, shoqëruar me ekografitë e fëmijës; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.12.2015 e znj. E. H. se deklaroi me vullnet të lirë dhe të plotë se ka 3 vjet, bashkëjeton me z. N. L. V.; deklarata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2021 e pajtimit e shtetasit D. M. me personin nën hetim, i cili deklaroi në përgjegjësinë time ligjore, personale në njohje të pasojave ligjore që sjell një deklaram i rremë se: Në lidhje me ngjarjen e ndodhur më 13.4.2021, në M***, ku është plagosur shtetasi N. V. deklaroi se marrëdhëniet mes nesh janë drejt normalizimit dhe nuk jam pavesuar i interesuar që të ndiqet penalisht, deklaratën e lëshoj me vullnet të lirë, e të plotë, për ta paraqitur përpara institucioneve kompetente për të gjitha efektet e ligjit*”.

⁵⁵Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t’i jepet termit “rrezik” në nenin 228 në tërësi, pra, edhe për rastin e germës “a” të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se *në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të “rrezikut”, pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia në rrezik e procesit të të provuarit nga ana e të pandehurit. Interpretimi i drejtë i dispozitës së germës “b”, të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale i sjell Kolegjet e Bashkuara në përfundimin unifikues se “rreziku i largimit”, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu, shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas germës “b” të pikës 1, të nenit 128, nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.*

e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij[...]”.

149. Në përfundim, lidhur me vendimmarrjen e subjektit për çështjen në fjalë, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar përgjithësisht bindëse lidhur me vendimmarrjen e tij në përputhje me kërkesat specifike të nenit 229, në të cilin përcaktohen kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë nuk konstatohen shkelje procedurale apo mangësi profesionale të kryera në lidhje me këtë çështje.

Vlerësimi përmbledhës mbi çështjet e analizuarra më lart

150. Nga shqyrtimi i çështjeve të sipërcituara ka rezultuar se vetëm në 3 raste, vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është ankimuar në Gjykatën e Apelit, dhe vetëm në një rast është vendosur ndryshimi i vendimit të marrë nga subjekti. Nga një vështrim i përgjithshëm i vendimmarrjeve të subjektit të lartpërkruara, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo tejkalime të masave të dënimeve të parashikuara nga dispozitat përkatëse, të cilat mund të kenë pasjellë favorizime evidente për të pandehurit e mbrojtur nga av. J. K. Për sa kohë gjykatësi ka vendosur brenda tagrave dhe diskrecionit vlerësues e vendimmarrës të atribuara funksionit të tij, përpos dyshimeve të mundshme, Komisioni nuk mund të konkludojë për ekzistencën e shkeljeve procedurale apo të favorizimit të personave të gjykuar.
151. Gjithsesi, në funksion të një vlerësimi dhe interpretimi sa më objektiv të dyshimit mbi konflikt interesi apo të paanësisë, trupi gjykues çmon të analizojë këtë çështje duke mbajtur në vëmendje edhe Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, si dhe përcaktimet sipas pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.
152. Në këtë këndvështrim, nga analiza e dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit, si dhe nga shpjegimet e subjektit, me shkrim si dhe në seancë, nuk u konstatuan veprime, shqyrtime apo vendime të ndërmarra nga subjekti në prezencën e ndonjë shtate të dukshme të konfliktit të interesave. Gjithashtu, duke konsideruar: (i) distancën e gjatë kohore nga udhëtimi i kryer me av. J. K. te shqyrtimi i çështjeve ku ai ishte mbrojtës, si një rrethanë lehtësuese; (ii) faktin se subjekti e ka vetëdeklaruar këtë udhëtim në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, të dërguara për Komisionin; (iii) faktin se në 8 çështjet e analizuarra nga Komisioni, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat ka qenë palë av. J. K., nuk ka rezultuar ndonjë vendim favorizues i palëve që ka përfaqësuar ky avokat; (iv) vlerësuar edhe rrethanën konkrete të një udhëtimi të vetëm, që ka zgjatur rreth 5 orë; (v) faktin se nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë marrëdhënie tjetër miqësore apo interesi e subjektit me këtë avokat, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk është gjendur në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

DENONCIME NGA PUBLIKU

153. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Aurel Arapi janë

paraqitur nga publiku në total 18 denoncime, por 6 prej tyre janë paraqitur në mënyrë të përsëritur nga i njëjti denoncues. Konkretisht, pranë Komisionit janë përcjellë 6 denoncime nga shtetasja XH. J. Po ashtu, ajo ka paraqitur ankesa pranë ILD-së, e cila ka vendosur arkivimin e tyre, pas shqyrtimit fillestar⁵⁶. Përgjatë procesit të rivlerësimit ka rezultuar se disa denoncues kanë paraqitur edhe kallëzime⁵⁷ penale ndaj subjektit – të cilat janë trajtuar në rubrikën “rivlerësimi i aftësive profesionale”. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me materialet përkatëse, nga ku është konstatuar sa vijon.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 5.12.2017**

154. Në këtë denoncim, shtetasja XH. J. ka ngritur pretendime për korrupsion dhe zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit. Ajo ka parashtruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga disa shtetas të tjerë⁵⁸ për kundërshtimin e vendimit nr. ***, të datës 25.3.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “pushimin e procedimit penal në ngarkim të ekspertes”, e kallëzuar për veprën penale “ekspertim i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se subjekti me vendimin nr. ***, të datës 30.1.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së sipërcituar me arsyetimin se veprimet hetimore janë të plota dhe vendimi i prokurorisë është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj.
155. Bazuar në pikën 6, të nenit 329, të Kodit të Procedurës Penale, në të cilën parashikohet se: *“Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake sipas shkronjës a) të paragrafit 3 të këtij neni, mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit i pandehuri dhe viktimi, ndërsa sipas shkronjave ‘b’ dhe ‘c’ të paragrafit 3, të këtij neni, mund të bëjë ankim prokurori”*, Komisioni vlerëson se për sa kohë pretendimi lidhet me themelin e çështjes dhe nuk evidentohen shkelje procedurale nga subjekti ky pretendim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni, por i organeve gjyqësore më të larta. Gjithashtu, sikurse është qartazi e përcaktuar në dispozitën e sipërcituar, pretendimet lidhur me vendimmarrjen e gjyqtarit janë të ankimueshme në gjykatat më të larta.
156. Ndërsa në lidhje me pretendimin e denoncueses për zvarritje të procesit gjyqësor, Komisioni ka analizuar vendimin objekt denoncimi dhe ka konstatuar se gjykimi ka zgjatur gjithsej 9 muaj dhe 16 ditë⁵⁹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

157. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, për sa i përket afatit të shqyrtimit të kësaj çështjeje, ai ka pretenduar se: *“[...] pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara vendimit unifikues i Gjykatës së Lartë, i vitit 2012, kanë theksuar se jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund t'i pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë, kompleksiteti i çështjeve në ngarkim etj.”*

⁵⁶Referuar edhe vendimit nr. *** prot., datë 26.1.2021, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës.

⁵⁷Trajtuar në rubrikën II “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

⁵⁸Denoncuesja nuk ka qenë palë në këtë proces, por ka qenë palë në procese të tjera gjyqësore, që kanë lidhje me çështjen objekt denoncimi, së bashku me palët të cilat kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të prokurorisë, në rastin konkret.

⁵⁹Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 4.4.2016 dhe vendimi është shpallur më 30.1.2017.

158. Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se gjykimi është kryer në përputhje me rregullat procedurale, shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore kanë qenë të ligjshme dhe të arsyetuara siç janë argumentuar në mënyrë të detajuar më lart dhe nuk kanë sjellë asnjë pasojë ligjore për cenimin e të drejtave të palëve pjesëmarrëse në proces.
159. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës sa vijon:
- a) vendimi nr. ***, datë 30.1.2017, me shënimin se vendimi është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 14.5.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe shkresën përcjellëse datë 28.1.2019, drejtuar Gjykatës së Lartë, për sa i përket rekursit të bërë nga ankuesit K. Xh. dhe R. K.;
 - b) procesverbalet e seancave gjyqësore të printuara nga sistemi ICMIS, për periudhën 9.5.2016 - 30.10.2017;
 - c) vendimi nr. *** prot., datë 26.1.2021, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

160. Komisioni ka vlerësuar se dispozita procedurale në fuqi në kohën e gjyqimit, duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes në gjykatë, datë 4.4.2016, konkretisht, neni 329 i Kodit të Procedurës Penale, parashikonte se: *“1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. 2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin. 3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri”*.
161. Për sa më sipër, me qëllim përlllogaritjen e kohëzgjatjes së gjyqimit, Komisioni ka konstatuar dhe vlerësuar, ndër të tjera, edhe në referencë të Sistemit të Vlerësimit që përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, sipas germës “a”, të pikës 5, të Aneksit 1, të cilit afati për gjykimin e çështjes në fjalë i është përcaktuar të zgjasë 4 muaj. Ndërkohë që nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni lidhur me këtë çështje, sikurse është cituar edhe më lart, ka rezultuar se kohëzgjatja e këtij gjykimi ka qenë 9 muaj e 16 ditë.
162. Komisioni ka administruar procesverbalet e seancave gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nga ku konstatohet se për shqyrtimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, si dhe seanca e fundit e shpalljes së vendimit. Nga këqyrja e procesverbaleve, si shkak për shtyrjen e seancave ka qenë kryesisht mosparaqitja e ankuesit dhe/apo mbrojtësit të tij në të paktën 5 seanca dhe, për këtë shkak, gjyqtari ka vendosur zëvendësimin e tij, mosparaqitja e prokurorit në të paktën 2 seanca, mosparaqitja e ekspertës në 1 seancë, si dhe shtyrja e një seance me kërkesë të kësaj të fundit për t’u njohur me dosjen.
163. Për të verifikuar ngarkesën e subjektit si një rrethanë që do të ndikonte në kohëzgjatjen e këtij gjykimi, Komisioni ka çmuar të marrë në konsideratë gjetjet e raportit të paraqitur nga KLGJ-ja, nga ku ka rezultuar se tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës subjektit i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 763 çështje ku përfshihen gjykimet e kryera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si stazhier, gjykimet e kryera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ato çështje ku ai është deleguar nga ish-KLD-ja në gjykata të tjera. Gjyqtari ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se ka përfunduar tre vitet e fundit 627 çështje, ndërsa ka mbartur vitin e fundit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin 136 çështje.

Gjithashtu ka rezultuar se ka qenë i deleguar për kryerjen e detyrës edhe në gjykata të tjera (vetëm për dy vite, 2015 – 2016, ka pasur 24 delegime), veç asaj ku ka qenë i emëruar.

164. Në përfundim, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse se mosrespektimi i afatit, nuk lidhet dhe nuk rrjedh nga mungesa e produktivitetit apo nga neglizhenca e subjektit dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit.

2. Denoncimet: nr. * prot., datë 16.4.2019; nr. *** prot., datë 2.12.2019; nr. *** prot., datë 23.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 3.10.2019**

165. Denoncuesja ka ngritur pretendime për shpërdorim detyre, korrupsion dhe shkelje të ligjit, si dhe pretendime për moskryerjen e hetimit dhe pushimin e çështjes gjyqësore ndaj disa gjyqtarëve, ku ndër të tjerë përmend edhe subjektin e rivlerësimit.

166. Nga shqyrtimi i këtyre denoncimeve, në lidhje me qartësimin e rrethanave të pretenduara nga denoncuesja, ka rezultuar se ajo nuk ka shprehur në mënyrë të qartë shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, duke qenë se denoncuesja nuk ka cituar/paraqitur dokumente konkrete në mbështetje të pretendimeve të saj ndaj subjektit të rivlerësimit dhe nuk referon ndonjë provë apo *indicie* mbi shkelje procedurale konkrete të kryera prej tij. Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se nuk janë evidentuar shkaqe konkrete dhe elemente për thellimin e mëtejshëm të hetimit.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 22.4.2021**

167. Denoncuesja ka ngritur pretendime për shpërdorim detyre, për korrupsion dhe shkelje të ligjit, ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ndaj subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar se nuk është ekzekutuar vendimi nr. ***, datë 11.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, si dhe vendimet nr. ***, datë 18.4.2017 dhe nr. ***, datë 18.4.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

168. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesja, Komisioni ka konstatuar⁶⁰ se pretendimet e denoncueses i referohen zbatimit të procedurës së ekzekutimit të vendimeve dhe jo veprimeve procedurale konkrete. Për më tepër, pretendimet mbështeten në vendimet dhe procedurat, të cilat nuk janë dhënë/kryer nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e denoncueses nuk qëndrojnë.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 17.9.2020, i shtetasit N. P.**

169. Shtetasi N. P. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime në lidhje me vendimin nr. ***, datë 19.7.2019 me objekt “vërtetim fakti”, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, duke e përshkruar si vendimmarrje të kundërligjshme, në kundërshtim me nenet 154, 309, 310, 388 dhe 389 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka ngritur pretendime zvarritjeje të procesit gjyqësor në një hark kohor mbi 2 vjet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

170. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me denoncimin e sipërcituar, subjekti ka sqaruar çështje civile, objekt denoncimi është regjistruar në gjykatë më 26.4.2019 dhe gjykata është shprehur me vendimin përfundimtar më 19.7.2019, duke vendosur: *“Pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj dhe në prova; vërtetimin e faktit juridik të qenies pronar të sipërfaqes së tokës 10.050 m² e ndodhur në Sh*** M*** dhe saktësimin e kufijve*

⁶⁰Komisioni, përveç dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesja ka verifikuar edhe *online* në sistemin informatik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, nga ku nuk kanë rezultuar vendime të marra nga subjekti, me të dhënat e referuara në denoncim. Vendimi i referuar me nr. ***, datë 11.11.2016, është dhënë nga një tjetër gjyqtar.

të pronësisë me sipërfaqe 10.050 m², sipas aktekspertimit topografik të ekspertit inxh. R.N.; një kopje e aktekspertimit i bashkëngjitet këtij vendimi ...”.

171. Subjekti i rivlerësimit, referuar qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues të vitit 2012, ka pretenduar se në këtë gjykim shtyrjet e realizuara nuk kanë ndikuar në zvarritje të pajustificuara dhe vonesat, në çdo rast, janë justifikuar në procesverbalin e seancës gjyqësore dhe kanë ardhur si rezultat i numrit të lartë të çështjeve në gjykim dhe delegimeve në disa rrethe gjyqësore njëkohësisht, ngarkesës në punë, (festave zyrtare, lejes vjetore, mbartja e dosjes në fundvit), që kanë ndikuar edhe në një planifikim më të largët të datës së radhës.
172. Në përfundim, subjekti ka ritheksuar se ka garantuar në çdo rast të drejtat e palëve në proces, ka përmbushur kërkesat e ligjshme të tyre procedurale, ka garantuar një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm, duke siguruar përmbushjen e aktekspertimit në mënyrë të rregullt, ka penalizuar sjelljet e paligjshme të palëve dhe ka eliminuar pengesat e krijuara nga të tretë ZVRPP Kurbin dhe eksperti, i caktuar gjatë gjykimit për të dhënë një vendim përfundimtar, të bazuar në prova dhe në ligj.
173. Vendimi është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dosja është përcjellë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresën përkatëse nr. *** prot., datë 9.9.2019, të kryesekretares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- a) vendimin nr. ***, datë 19.7.2019, i cili rezulton se është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dosja është përcjellë pranë saj me shkresën përkatëse nr. *** prot., datë 9.9.2019, të kryesekretares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
 - b) procesverbalet e seancave gjyqësore të printuara nga sistemi ICMIS, nga data 15.6.2017 – 19.7.2019.

Vlerësimi i trupit gjykues

174. Nga shqyrtimi i vendimit objekt denoncimi, Komisioni ka konstatuar se nëpërmjet këtij vendimi subjekti ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj e në prova dhe vërtetimin e faktit juridik të pronësisë ...”*. Për sa i përket pretendimit për zvarritje të procesit gjyqësor, nga analiza e vendimit⁶¹ ka rezultuar se çështja objekt denoncimi është regjistruar në gjykatë në datën 26.4.2017 dhe vendimi është shpallur në datën 28.9.2019. Për rrjedhojë konstatohet se gjykimi ka zgjatur gjithsej 2 vjet e 5 muaj dhe 2 ditë, pra jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit⁶².
175. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse, për sa kohë shtyrjet e afatit kanë qenë pasojë e kryerjes së veprimeve procedurale të nevojshme dhe në caktimin e datave të seancave ka ndikuar ngarkesa e gjyqtarit, si dhe fakti se ai ka qenë i deleguar për gjykimin e çështjeve në rrethe të ndryshme. Për rrjedhojë, vlerësohet se mosrespektimi i afateve nuk lidhet dhe nuk rrjedh nga mungesa e produktivitetit apo nga neglizhenca e subjektit dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit.
176. Ndërsa, lidhur me pretendimin për vendimmarrje të kundërligjshme, trupi gjykues vlerëson

⁶¹Referuar vendimit të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, në linkun: <http://www.gjykata.gov.al/umbraco/Surface/SearchSurface/GenerateAndDownloadFinalDecisionReport?caseId=35-2017-00617&courtId=35>

⁶²Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

se ky pretendim është në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret në funksion të procesit të rivlerësimit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 29.10.2020, i shtetasit CH. C.**

177. Shtetasi Ch. C. ka depozituar denoncimin ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi sipas tij subjekti ka zhvilluar një proces gjyqësor të kundërligjshëm, së pari sepse nuk është në kompetencën territoriale ku subjekti ushtron detyrën dhe së dyti ka zhvilluar disa seanca duke mos njoftuar palët. Denoncuesi nuk ka paraqitur të dhëna/prova konkrete lidhur me pretendimet e tij.
178. Nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se denoncuesi ka paraqitur edhe një kallëzimin penal me nr. ***, datë 10.2.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili është trajtuar më herët në këtë vendim⁶³ dhe nuk janë gjetur shkelje të subjektit.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 14.12.2017, i shtetasës A. D.**

179. Shtetasja A. D. ka ngritur pretendime për korrupsion, pa referuar ndonjë vendim apo çështje në lidhje me një prokuror, një gjyqtar, si dhe për subjektin e rivlerësimit. Sipas saj, në procesin gjyqësor, në të cilin ajo ka qenë palë, prokurori në bashkëpunim me gjyqtarin e çështjes nuk kanë kryer hetimet e nevojshme, por kanë favorizuar “vrasësin”, i cili është paraqitur si i sëmurë, nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.
180. Nga shqyrtimi i denoncimit duket se pretendimet e denoncueses janë shprehje të karakterit të përgjithshëm dhe lidhen me vendimmarrjen, pra me thelbin e çështjes dhe nuk referojnë ndonjë provë apo moszbatim të procedurave ligjore konkrete nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 11.2.2019, i shtetasit M. V.**

181. Shtetasi M. V. ka depozituar denoncimin ndaj subjektit të rivlerësimit, në të cilin ka parashtruar se ai ka kryer shkelje flagrante të ligjit dhe ka favorizuar palën paditëse në vendimin nr. ****, të datës 19.11.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.
182. Komisioni, përgjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me çështjen, ka administruar⁶⁴ vendimin në analizë, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Së bashku me vendimin, gjykata, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2021, ka bërë me dije se dosja në lidhje me çështjen objekt denoncimi ndodhet në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, fakt ky i konstatuar edhe nga Komisioni nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë⁶⁵, ku çështja me të dhënat e sipërcituara ka qenë në proces përpunimi dhe ende nuk ka një vendimmarrje lidhur me të.
183. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti në vendimmarrje është bazuar në aktekspertimin i cili, sipas tij, ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe se në këtë akt nuk janë kryer/përfshirë të gjitha detyrat e lëna nga gjyqtari. Në lidhje me pretendimin për “vlefshmëri juridike” apo “kundërligjshmërisë”, të pretenduar nga denoncuesi, trupi gjykues çmon se edhe pse dispozita e nenit 185 nuk përmban rregullim normativ lidhur me aspekte të tilla, si: njoftimi i palëve të tjera (të pandehurit, mbrojtësit dhe viktimës) dhe administrimi i pretendimeve të tyre, pala e interesuar kur ndodhet përpara mosnjoftimit apo kundërshtimit të pretendimeve të saj, duke respektuar kërkesat e dispozitës së nenit 129 të Kodit të

⁶³Trajtuar në rubrikën “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

⁶⁴Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 26.7.2021, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁵<http://www.gjykata.gov.al/apel-shkod%C3%ABr/gjykata-e-apelit-shkod%C3%ABr/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/>

Procedurës Penale, mund të pretendojnë pavlefshmërinë relative të këtij akti.

8. Denoncimi nr. * prot., datë 15.1.2020, i shtetasve A. A. dhe M. L.**

184. Shtetasit A. A. dhe M. L., nëpërmjet formularit të denoncimit, kanë denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave, si dhe në mungesë të palëve të paditura (denoncuesve), por pa iu referuar konkretisht ndonjë vendimi të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.
185. Gjithashtu, ata kanë pretenduar se zgjatja e afatit të pezullimit të ekzekutimit me tre muaj (pasi ishte vendosur njëherë pezullimi me 3 muaj dhe kjo periudhë kishte përfunduar) në kundërshtim me nenet 609 dhe 202 të Kodit të Procedurës Civile, çka e bën vendimmarrjen e tij të kundërligjshme. Denoncuesit kanë parashtruar se kanë paraqitur edhe kallëzim penal ndaj subjektit, fakt i cili ka rezultuar edhe nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit administrativ⁶⁶ të kryer nga Komisioni.
186. Konkretisht, ata kanë paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë kallëzimin penal me nr. ***, datë 10.2.2020, në të cilin është trajtuar në këtë vendim⁶⁷. Ndryshe nga sa kanë pretenduar denoncuesit, Komisioni ka konstatuar se vetë denoncuesit kanë cituar në kallëzim se janë njoftuar për procesin gjyqësor të datës 16.12.2019, nëpërmjet fletëhirrjes nr. *** akti, të datës 10.12.2019. Për rrjedhojë, pretendimi i tyre për mosnjoftim nga gjykata, nuk qëndron.
187. Ndërsa në lidhje me pretendimin për zgjatjen e afatit të pezullimit të ekzekutimit, Komisioni nuk mund të hetojë ligjshmërinë e vendimmarrjes apo urdhëresave të një gjykate, përderisa ky aspekt zgjidhet nga shkallët hierarkike të gjyqësorit si mekanizma kontrolli ndaj gjykatave më të ulëta, duke parashikuar edhe instrumentet ligjore për ndreqjen eventuale të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, denoncimi në fjalë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

9. Denoncimi nr. * prot., datë 13.3.2019, nga shtetasi F. S.**

188. Shtetasi F. S., nëpërmjet denoncimit të paraqitur, ka ngritur pretendime ndaj një prokurori që ka vendosur pushimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, të datës 9.6.2017, të bërë nga denoncuesi, si dhe ndaj subjektit të rivlerësimit për arsye se ky i fundit me vendimin nr. ***, të datës 26.2.2019, me objekt “goditje për falsitet dokumentacioni, deklarin e pavërtetë të AMTP-së nr. ***, datë 6.4.1994, në emër të shtetasit M. V.”, ka lënë në fuqi vendimin e prokurorit.
189. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti ka mbyllur hetimet, por nuk ka përshkruar shkelje procedurale specifike të kryera prej tij dhe as nuk ka paraqitur të dhëna/prova lidhur me pretendimet e tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

190. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me këtë çështje, subjekti ka deklaruar se në përfundim të gjykimit ka arritur në konkluzionin se kërkesëpadia ka qenë e bazuar në prova dhe në ligj dhe, si e tillë, duhej pranuar duke bërë deklarin e pavërtetë të AMTP-së nr. ***, datë 6.4.1994, në emër të shtetasit M. V.⁶⁸, kërkim, i cili ishte edhe pjesë e objektit të

⁶⁶Shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2021.

⁶⁷Kallëzim penal nr. ***, i vitit 2020, trajtuar në rubrikën II. “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

⁶⁸Në zbatim të pikave 1 dhe 2, të nenit 275, të Kodit të Procedurës Civile, ku citohet se: “*Sekretaria e gjykatës dërgon menjëherë kopjen e çdo vendimi që shpall shkresën si të falsifikuar te prokurori dhe në organin shtetëror që ka nxjerrë shkresën. Shkresa që shpallet e falsifikuar nuk i jepet ndërgjyqësit, por mbetet në arkivin e gjykatës, së bashku me vendimin që shpall shkresën të falsifikuar. Në këto raste sekretari shënon mbi shkresë se ajo është e falsifikuar*”, gjykata ka konkluduar edhe se një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin si dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive

padisë, prej fillimit. Gjithashtu, ka deklaruar se në këtë vendimmarrje ka qenë i bindur në pavërtetësinë e ekzistencës së këtij akti, për arsye si vijon:

- *së pari, për shkak të krijimit të elementëve të rremë në këtë akt, të ndryshëm nga modelet krahasues, të zgjedhur nga ana e ekspertit, referuar vulës së përdorur;*
- *së dyti, sepse rezulton i krijuar më vonë në raport me aktet e tjerë të njëjtës kohë, referuar nr. të regjistrimit, që rezulton më i madh se modelet krahasues të periudhës së muajit qershor 1994;*
- *së treti, përdorimit të termit Kurbin, G*** dhe jo Laç, që kanë dalë më vonë, pasi Rrethi Kurbin si term është njohur si tillë dhe është përdorur zyrtarisht pas miratimit të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për Organizimin dhe Pushtetin Vendor në Republikën e Shqipërisë”;*
- *së katërti, mungesës së elementëve të detyrueshëm si nënshkrimi i përfaqësuesit të Rrethit;*
- *së pesti, gjatë diskutimit të aktekspertimit, në seancë gjyqësore edhe nga ana e ekspertit u shpjegua e u plotësua se shkrimi i P. S. ndryshon dhe ky ndryshim, vjen si pasojë e moshës apo ndonjë sëmundje, çka tregon se kjo AMTP është plotësuar më vonë.*

191. Gjykata ka referuar edhe se në bazë të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal” dhe gjithashtu VKM-ja nr. 269, datë 25.6.1992, “Për ndarjen administrative tokësore të Republikës së Shqipërisë”, nuk rezulton që të ketë ekzistuar termi “Rrethi Kurbin”, pasi sipas VKM-së së sipërcituar është njohur vetëm Rrethi Laç, i cili përbehet nga Bashkia Laç dhe komunat Mamurras, Milot dhe Fushë Kuqe. Rrethi Kurbin është njohur si i tillë dhe është përdorur zyrtarisht pas miratimit të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për Organizimin dhe Pushtetin Vendor në Republikën e Shqipërisë”.

192. Vendimi nr. ***, datë 19.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është ankimuar nga pala gjyqumbëse e paditur M. V. dhe rezulton se pretendimet e tij lidhen më tepër me vlerën e fuqinë provuese të aktekspertimit kriminalist, grafik-teknik (pretendime që lidhen me themelin e çështjes) dhe dosja është përcjellë për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2019, të kancelarisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:

- a) vendimin nr. ***, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, bashkëlidhur shkresa nr. *** prot., datë 16.1.2019, e kancelarisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku dosja është përcjellë për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (dosja nuk gjendet më në arkivin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin);
- b) procesverbalet e seancave gjyqësore të çështjes në mungesë të dosjes nga data 28.5.2018 – 19.11.2018, të printuara nga sistemi ICMIS.

Vlerësimi i trupit gjykues

193. Trupi gjykues vlerëson se faktet e pretenduara në denoncim nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ky u fundit ka dhënë një shpjegim të qartë dhe bindës, në lidhje me veprimet e kryera prej tij në procesin gjyqësor objekt denoncimi.

194. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e denoncuesit se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke mbyllur hetimet, ndonëse duken të paprovuara nga dokumentacioni i përcjellë në Komision, lidhen me themelin dhe me logjikën apo bindjen

të Paluajtshme Kurbin dhe Bashkisë Kurbin, si organe shtetërore, që kanë në administrim dhe përpunim aktin, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyquese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar. Për rrjedhojë, ky denoncim e pretendim tejkalon kompetencat kushtetuese të Komisionit dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt hetimi e shqyrtimi në funksion të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 3.6.2019, nga shtetasi R. M.**

195. Shtetasi R. M. ka paraqitur denoncimin, në të cilin përmend disa gjyqtarë dhe ndërmjet tyre edhe subjektin Aurel Arapi. Ai ngre pretendime për shkelje procedurale, të cilat ndikojnë në zhvillimin e një procesi të drejtë e të paanshëm gjyqësor. Konkretisht, denoncuesi ka pretenduar se nuk i janë pranuar kërkesat e përsëritura për të qenë pjesë e procesit gjyqësor.
196. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin⁶⁹, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë⁷⁰, pranë të cilave subjekti ka ushtruar detyrën, të paraqesin vendime të mundshme të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, me palë denoncuesin R. M., si dhe kopje të kërkesave për ndërhyrje në procesin gjyqësor dhe fletëthirrje të gjykatës drejtuar këtij shtetasi (nëse disponohen). Në përgjigje të shkresave të sipërcituara, këto gjykata kanë bërë me dije⁷¹ se nga verifikimi i kryer në regjistrin ICMIS dhe në regjistrat penalë dhe civilë nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti as si gjyqtar i vetëm dhe as si anëtar trupi gjykues.
197. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar bashkë me denoncimin, nuk kanë rezultuar prova apo dokumente konkrete në lidhje me subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nuk janë evidentuar *indicie* dhe as konstatuar shkelje procedurale të subjektit, që mund të bëjë të nevojshme hetime të mëtejshme, për sa kohë nuk janë plotësuar elementet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

11. Denoncimi nr. * prot., datë 25.11.2019, i shtetasve F. M. dhe M. M.**

198. Shtetasit F. M. dhe M. M. kanë denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të kundërligjshme, me pretendimin se janë dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale, në shkelje të parimit të ndalimit të gjyqimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale, si dhe kanë pretenduar se subjekti, fillimisht, ka lejuar e më pas e ka ndaluar kryerjen e ekspertimit të kërkuar nga denoncuesit, në cilësinë e të pandehurve në procesin gjyqësor në të cilin ata kanë qenë të pandehur.
199. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 18.7.2018, për veprën penale “mashttrim”, e parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, nga shoqëria “B.”, kundër denoncuesve. Ky kallëzim ka rezultuar në plotësim dhe në vijim të kallëzimit të bërë më 16.2.2015 (për të cilin çështja ka rezultuar në proces në Gjykatën e Lartë), për shkak se janë zbuluar prova/fakte të reja.
200. Komisioni çmon se pretendimi për cenimin e parimit *ne bis in idem* duket i pabazuar, pasi ndaj kërkuesit nuk ka filluar një procedim i ri për të njëjtin fakt për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, si dhe as nuk është gjykuar ose dënuar për të njëjtën vepër penale, por siç qartësisht evidentohet në dokumentacionin e administruar, procedimi i ri ka nisur në bazë të provave dhe fakteve të reja. Në këto kushte evidentimi i provave të reja, mund të passjell një rishikim dhe një përcaktim të ndryshëm juridik.
201. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të denoncuesit në lidhje me kryerjen e ekspertimit, kjo

⁶⁹Kërkesë për informacion nr. *** prot., datë 26.7.2021, të dërguar nga Komisioni.

⁷⁰Kërkesë për informacion nr. *** prot., datë 26.7.2021, të dërguar nga Komisioni.

⁷¹Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.8.2021, nga gjykata; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.8.2021, nga gjykata.

është një procedurë e përcaktuar në nenet 176 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, ku ndër të tjera parashikohet se organi procedues disponon me vendim të motivuar lidhur me kryerjen e ekspertimit. Në këtë këndvështrim, ky pretendim lidhet me themelin e çështjes dhe për këtë arsye nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni, ndonëse mund të përbëjë objekt ankimi në organet hierarkike të sistemit gjyqësor.

12. Denoncimi nr. * prot., datë 2.8.2018, nga shtetasi P. LL.**

202. Shtetasi P. LL. ka denoncuar disa gjyqtarë dhe prokurorë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit Aurel Arapi, duke pretenduar se ata kanë shpërdoruar detyrën dhe kanë fshehur krimin. Nga përmbajtja e denoncimit dhe dokumentacioni bashkëlidhur tij ka rezultuar se denoncuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë “Për pushimin e çështjes penale me nr. 240 të vitit 2015”. Kërkesa në fjalë ka rezultuar e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 6.12.2016, ka vendosur rrëzimin e saj. Në vijim, denoncuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë për ndryshimin e vendimit të sipërcituar dhe pranimin e kërkesës, me pretendimin se vendimi është i pabazuar në ligj dhe në prova. Kjo e fundit nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 18.7.2018, ka konstatuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ankuesit dhe se veprimet hetimore të kryera nga prokuroria kanë qenë të plota dhe vendimmarrja ka qenë e drejtë.
203. Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë në mbështetje të arsyetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, sipas të cilit pavlefshmëria e një akti administrativ mund të goditet vetëm si i pavlefshëm përmes juridiksionit administrativ ose juridiksionit gjyqësor civil, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, nga shqyrtimi i denoncimit dhe analiza e vendimeve të përshkruara më sipër nuk kanë rezultuar shkelje nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara në prova e në ligj dhe gjithsesi lidhen me themelin e çështjes, gjë e cila nuk hyn në juridiksionin e organeve të rivlerësimit.

13. Denoncimi nr. * prot., datë 10.9.2021, nga shtetasi P. L.**

204. Shtetasi P. L. ka denoncuar një prokuror, si dhe subjektin e rivlerësimit Aurel Arapi. Nga përmbajtja e denoncimit dhe dokumentacioni bashkëlidhur tij ka rezultuar se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në datën 7.4.2021, është regjistruar materiali kallëzues, i dërguar nga Komisariati i Policisë Kurbin, lidhur me kallëzimin e shtetasit P.L. ndaj shtetasit E. Ç. për veprën penale “pushtim i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, kallëzim i cili është regjistruar me nr. ***. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, nëpërmjet vendimit të datës 10.6.2021 ka vendosur: *“Pushimin e çështjes penale nr. ***”, akti në ngarkim të E. Ç., i kallëzuar penalisht për “pushtim toke”, vepër penale, e parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal”*.
205. Denoncuesi ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 22.7.2021 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit të pushimit, datë 10.6.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”*.
206. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se vendimmarrja e subjektit ka qenë në përputhje me afatet e përcaktuara kohore, konkretisht, gjykimi ka zgjatur gjithsej 15 ditë⁷², pra brenda afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “a”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit⁷³. Gjithashtu, nga analiza e vendimit ka

⁷²Çështja është regjistruar në datën 2.7.2021 dhe vendimi është shpallur në datën 22.7.2021.

⁷³Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

rezultuar se gjykimi i çështjes ka qenë në juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës dhe është zhvilluar dhomë këshillimi, në zbatim të pikës 3, të nenit 329, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: *“Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve”* dhe palëve iu është bërë me dije e drejta e ankimit.

207. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk janë konstatuar shkaqe apo mangësi, të cilat do të përbënin shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

14. Denoncim nr. * prot., datë 21.10.2021**

208. Nga një denoncues anonim janë ngritur pretendime në lidhje me pushimin e gjykimit në kundërshtim me ligjin dhe provat në dosjen e gjykimit të çështjes penale, ku e kallëzuar ka qenë kryetarja e Gjykatës Lezhë, shtetasja O. N. dhe që është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ka ngritur gjithashtu pretendime në lidhje me konflikt interesi ndërmjet subjektit dhe të kallëzuarës, për shkak se kanë qenë në të njëjtën trupë gjykues në disa çështje.

209. Përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka administruar vendimin nr. ***, datë 30.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, mbi të cilin ngrihet denoncimi në fjalë. Nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se në këtë proces gjykata ka çmuar se: *“Kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 19.2.2019”, të regjistruar për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal është e bazuar në ligj dhe duhet të pranohet pasi nuk rezulton të ndodhemi para kryerjes së veprës penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal apo ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar nga legjislacioni penal, nga ana e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, znj. O.N.*

210. Përgjatë hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se vendimi në fjalë është gjetur i drejtë dhe është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

211. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit të njoftuara nga Komisioni, në referim edhe të përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, ka deklaruar mungesën e çdolloj konfliktit interesi me kolegen e tij znj. O. N., e cila ushtron detyrën e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

212. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se znj. O. N. nuk ka qenë palë pjesëmarrëse në këtë gjykim, gjatë ushtrimit të detyrës prej tij, si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin apo edhe në gjykatat e tjera ku subjekti ka qenë i deleguar për gjykim të çështjeve të caktuara. Njohja e tij me gjyqtaren në fjalë ka qenë për shkak të delegimit të tij në gjykime të tjera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si ato në Dibër, Krujë dhe Lezhë.

213. Vendimmarrjet e tij, përfshirë edhe vendimin nr. ***, datë 30.9.2019, nuk kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit, kanë qenë ligjore, të bazuara në prova, të pandikuara çka konfirmohet edhe nga mbështetja e këtyre vendimeve edhe në gjykatat më të larta, ku vendimi në fjalë është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, referuar shënimit të Kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: vendimin nr. ***, datë 30.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, referuar shënimit të Kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vlerësimi i trupit gjykues

214. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi etiko-profesionale nga subjektit, për sa kohë, nga sa është disponuar nga Komisioni, nuk janë evidentuar rrethana konkrete që do të përbënin elemente të konfliktit të interesit, për shkak të të cilave subjekti do të duhej të kishte paraqitur kërkesën për dorëheqje.

15. Komisioni, gjithashtu, ka administruar shkresën me nr. *** prot., datë 3.2.2020, nga shoqëria R. B., si dhe shkresën me nr. *** prot., datë 28.2.2020, të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe adresohen nga “R. Bank” në formën e kërkesës për informacion drejtuar ILDKPKI-së, si dhe Komisionit për dijeni. Këto shkresa nuk referojnë prova apo shkelje procedurale konkrete që mund të jenë kryer nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë aty nuk u gjenden *indicie* apo shkaqe për hetim më të thelluar, sipas nenit 53 të ligjit nr.84/2016.

LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me artikuj të publikuar në disa media *online*⁷⁴, nga analizimi i të cilave janë konstatuar disa denoncime si vijojnë:

1. Denoncimi nga emisioni investigativ “F. F.”

215. Emisioni investigativ “F. F.” ka denoncuar veprimet e një avokati, sekser i gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ai arriti të lironte dhe të pushonte hetimin për një të pandehur të akuzuar për kultivim të bimëve narkotike. Shtetasi K. S., i pyetur nga F. F. ka deklaruar se: “Avokati na ka përmendur një gjyqtar me mbiemër Arapi, emrin nuk ia di. Për atë thoshte se i kishte eurot”.

216. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin⁷⁵, në përgjigje të shkresës⁷⁶ së dërguar nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 3.2.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit K. S. për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “kultivimi i bimëve narkotike” dhe dënimit e tij me tre vjet burgim, duke aplikuar uljen e dënimit me 1/3 e dënimit të dhënë bazuar në neni 406 të Kodit Penal. Nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se në këtë gjykim i pandehuri ka qenë i përfaqësuar nga av. E. B.

217. Vendimi i subjektit ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka regjistruar çështjen me kërkesë shtetasin K. S. me objekt “kundërshtimin pjesërisht të vendimit të sipërcituar për shkak të mosaplikimit prej saj të nenit 59 të Kodit Penal, si dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin në kohë prove, me qëllim që gjatë periudhës së provës i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale” dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 1.3.2018, ka

⁷⁴Denoncim nga Top-Chanel, skandali 6.000 euro gjyqtarëve për të mbyllur çështjen në linkun: <https://top-channel.tv/2019/09/09/skandali-6-mije-euro-gjyqtareve-per-te-mbyllur-ceshtjen/>; denoncim nga CNA.al 6 000 euro për të mbyllur një dosje?/ Nga pasuria te heshtja e skandalit për gjyqtarin e Kurbin në linkun:<https://www.cna.al/2020/11/21/6-000-euro-per-te-mbyllur-nje-dosje-nga-pasuria-tek-heshtja-e-skandalit-per-gjyqtarin-e-kurbinit/>; denoncim nga 360.al grade në linkun<https://360grade.al/361066/me-e-mbyll-me-6-mije-euro-je-i-knaq-duhet-nafte-me-maru-pune-ctfare-premtonte-avokati-i-arrestuar-i-doli-video-duke-kerkuar/>; denoncim nga panorama.com në linkun <http://www.panorama.com.al/u-arrestua-sot-ne-kurbin-kush-eshte-avokati-i-denoncuar-publikisht-per-korrupsion-mori-6-mije-euro-e-miliona-leke-per-nje/>; denoncim nga News Bomb në linkun <https://newsbomb.al/skandali-avokati-sekser-6-mije-euro-gjyqtareve-per-te-mbyllur-ceshtjen/>

⁷⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁷⁶Dokumentacioni i përcjellë nga gjykata nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2021.

vendosur mospranimin e ankimit.

218. Në vijim, nga aktet ka rezultuar se nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 24.5.2021, kjo gjykatë e ka përcjellë dosjen në fjalë pranë Gjykatës së Lartë, në të cilën duket se është në fazë studimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

219. Subjekti ka sqaruar se ky denoncim lidhet me vendimin nr. ***, datë 3.2.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që ka deklaruar fajtor të pandehurin K. S., për kryerjen e veprës penale “kultivim të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal. Subjekti ka vlerësuar se nga ana objektive vepra penale është kryer me veprime aktive të kundërligjshme të të pandehurit, e cila duhet të kualifikohet sipas nenit 284/1 të Kodit Penal, në kushtet kur i pandehuri K. S. ka realizuar kultivimin e bimëve narkotike të llojit “*Cannabis Sativa*”, ku nga kontrolli dhe nga këqyrja e vendit të ngjarjes rreth 4 metra larg banesës së tij kultivoheshin në fazën e rritjes 75 bimë narkotike *Cannabis Sativa*.
220. Në rastin konkret, kërkesa e organit të akuzës kishte kërkuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar dhe dënimit të pandehurit në masën e 3 vjet burg, ndërsa mbrojtësi i të pandehurit kishte kërkuar caktimin e një dënimi në minimumin e kufijve të parashikuara nga ligji, si dhe të aplikohet neni 59 i Kodit Penal.
221. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka çmuar se dënimi ndaj të pandehurit K. S. me 3 vjet e 3 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal, për shkak të mungesës së rrezikshmërisë së madhe të autorit dhe rrethanave lehtësuese më sipër është një dënim plotësisht i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit në rastin konkret. Për shkak se ndaj të pandehurit u zhvillua gjykimi i shkurtuar, bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, masa e dënimit ulet me 1/3 (një të tretën) e tij dhe, përfundimisht, i pandehuri K. S. është dënuar me dy vjet e dy muaj burgim.
222. Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.3.2018, e cila ndër të tjera ka vendosur mospranimin e ankimit të ushtruar nga i pandehuri K. S. ndaj vendimit nr. ***, datë 3.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vlerësimi i trupit gjykues

223. Trupi gjykues, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, çmon se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij, lidhur me këtë çështje.
224. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se vendimi objekt vlerësimi, për sa i përket mënyrës se si është arsyetuar dhe argumentuar, shoqërohet nga një vijë logjike dhe interpretative e arsyeshme mbi provat dhe përdorimin e aplikimin e harmonizuar të legjislacionit të aplikueshëm lidhur me rastin, duke plotësuar në këtë mënyrë parashikimet e pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor. Si rrjedhojë nuk janë konstatuar dobësi apo mangësi në arsyetimin e vendimit përkatës.

2. Denoncim në median online ABC News⁷⁷

225. Referuar publikimit në median e sipërcituar, ka rezultuar se prokurori i çështjes ka kërkuar caktimin e masës “arrest në burg” për shtetasit N. V., Gj. F. dhe të afërmin e tyre R. F., të cilët plagosën policët I. Z. dhe F. Ll., në M***. Gjyqtari Aurel Arapi e rrëzoi këtë kërkesë duke vendosur “arrest në burg” vetëm për shtetasin N. V. dhe për dy shtetasit e tjerë “detyrim paraqitje”. Ai caktoi po detyrim paraqitje edhe për efektivin D. M., i cili në kushtet e vetëmbrojtjes, qëllon në ajër me armën e shërbimit. Për shkak të qitjes së pavullnetshme u plagosën dy kolegë të tij dhe shtetasi N. V.
226. Me qëllim verifikimin e fakteve të denoncuara, që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, është administruar vendimi gjyqësor i dhënë prej tij, në funksion të vlerësimit të aspektit profesional të subjektit. Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin të paraqesë dosjen me të dhënat sipas lajmit të përshkruar më sipër.
227. Përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin⁷⁸, dosjen që lidhet me denoncimin në fjalë për shkak të disa *indicieve* të marra. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se bëhet fjalë për të njëjtën çështje me atë të denoncuar nga media në rastin konkret, në lidhje me të cilën Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar në rubrikën “C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

3. Lidhur me informacionin njohur nga media online Dosja.al

228. Nga publikimet në mediat e sipërcituara ka rezultuar se: Gjykata e Kurbinut ka dhënë masën e sigurisë “arrest në burg” ndaj shtetasve F. dhe E. B., nën akuzën për grabitjen me dhunë të një ish-efektivi të policisë së burgjeve, ngjarje e ndodhur në qershor të vitit 2011, në M***. Sipas akuzës së prokurorit B. Sh., gjyqtari Aurel Arapi e ka konsideruar të ligjshëm ndalimin e personave nën hetim dhe ka vendosur ndaj tyre masën e sigurisë “arrest në burg” për veprat penale “vjedhje me dhunë”, kryer në bashkëpunim dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”. Mediat kanë bërë me dije se pas 9 vjetësh janë arrestuar shtetasit E. dhe F. B., me akuzën se në vitin 2011 grabitën dhe dhunuan efektivin z. D., që në atë kohë shërbente pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

229. Subjekti ka deklaruar se si gjyqtar i hetimeve paraprake me kërkesë të organit të akuzës me vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çmon si të drejtë caktimin si masë sigurimi ndaj personit nën hetim E. B., atë të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për shkak të rrezikshmërisë relativisht të lartë të këtyre veprave penale, ku Kodi Penal i parashikon si krime, me sanksione vetëm me burgim, ku konkretisht në nenin 139 të Kodit Penal parashikohet se: “*Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet*” dhe në nenin 278/1 të Kodit Penal parashikohet se: “*Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet*”. Në këto kushte, gjykata pranon kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për sa i përket caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim E.B.
230. Në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit E. B., gjykata ka parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale. Masa e sigurimit personal që do

⁷⁷Në linkun: https://abcnews.al/plagosi-koleget-e-tij-ne-mamurras-gjykata-e-kurbinit-le-te-lire-d***-m***.

⁷⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

të caktohet për shtetasin F. B. duhet të jetë në përputhje me shkallën e nevojave të sigurimit. Kjo masë duhet të jetë në raport të drejtë me rëndësinë e faktit dhe sanksionin e parashikuar për veprat penale nga nenet 139, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal, nisur nga fakti se personi nën hetim dyshohet se ka kryer këto vepra penale dhe ekziston rreziku i përsëritjes së tyre, mundësia e ardhjes së pasojave më të rënda, referuar edhe mënyrës së kryerjes së veprës penale, përmes ushtrimit të dhunës dhe në bashkëpunim dhe pasojave të ardhura, referuar dëmtimeve të konstatuara te viktima shtetasi A. D., përmes kësaj caktimit të kësaj mase ekstreme sigurimi.

231. Subjekti ka arsyetuar në vendim se ky cilësimi juridik, referuar veprave penale, për të cilën dyshohen autorët mund të jenë subjekt i ndryshimit të mëvonshëm, referuar veprës penale të atribuuar atyre, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, për shkak të vijimit të hetimeve dhe ende mbetemi në kuadrin e dyshimeve dhe jo ngritjes së akuzës për njërin nga të dy autorët. Vendimi në fjalë është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 13.1.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, pas ankimit të shtetasit E. B., referuar shënimit të Kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, marrë formë të prerë më 28.12.2020 për shtetasin F. B., në mungesë të ankimit të tij dhe lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 13.1.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, pas ankimit të shtetasit E. B., referuar shënimit të Kryesekretarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vlerësimi i trupit gjykues

232. Nisur nga sa më lart, duke konsideruar se vendimmarrja e subjektit, si për sa i takon dërgimit në gjyq ashtu edhe për sa i takon pushimit të gjykimit të akuzës është konfirmuar edhe nga ana e trupave të tjerë gjykues të gjykatave më të larta, si dhe duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij.
233. Trupi gjykues çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsyeime të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të gurmës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;
- d. në lidhje me çështjen penale nr. *** akti, të viti 2017, të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për të cilin është dhënë vendimi nr. ***, datë 21.4.2017, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, kjo çështje duhet të transferohet pranë organit kompetent për inspektim, nëse verifikohen shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, transferimin e çështjes penale nr. *** akti të vitit 2017 – me palë ndërgjyqëse: të paditur A. Gj., E. D., me objekt “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal” – të shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 1.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

*Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli*